



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/
Ministry of Internal Affairs
Inspektorati Policor i Kosovës



RAPORTI VJETOR 2015



Ministria e Punëve të Brendshme
Inspektorati Policor i Kosovës

Raporti vjetor 2015

RAPORTI VJETOR 2015



PËRMBAJTJA

1. FJALA HYRËSE E MINISTRIT
2. FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV
3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E IPK-së
4. SHEMBULLI I SUKSESIT NË IPK-së
5. 10 VJET NGA THEMELIMI I INSPEKTORATIT POLICOR TE KOSOVES
6. TRAJNIMET E IPK-së NDËR VITE 2011-2015
7. PAISJET TEKNOLOGJIKE TË IPK-së- DHOMA E INTERVISTIMIT
8. PARTNERITETI I IPK-së ME ICITAP-in AMERIKAN
9. SFIDAT DHE TË ARRITURAT KRYESORE TË IPK-së GJATË VITIT 2015
10. PRANIMI I ANKESAVE DHE HETIMI I RASTEVE GJATË VITIT 2015
11. GRADAT DHE NJESITE STRUKTURORE NGA VIJNE PUNONJËSIT E PK-SË TË HETUAR NGA IPK-JA
12. INSPEKTIMET GJATË VITIT 2015
13. MBËSHTETJA ADMINISTRATIVE DHE LOGJISTIKE TË FUNKSIONEVE TË IPK-së GJATË VITIT 2015
14. PROJEKTI PËR REGJIONALIZIMIN E IPK-së
15. BASHËPUNIMI ME QYTETARË
16. AMERIKA PËR KOSOVËN
17. BASHKPUNIMI ME MEDIA
18. DIZAJNIMI DHE ORGANIZIMI I FUSHATËS PËR “LINJËN E KALTËR”
19. REVISTA INTEGRITETI
20. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT
21. BASHKËPUNIMI ME KMDLNJ-NË (KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT)
22. BASHKËPUNIMI ME KOMISIONIN PARLAMENTAR PËR SIGURI, PUNË TË BRENDSHME DHE MBIKËQYRJE TË FSK-SË
23. BASHKËPUNIMI ME PROKURORINË
24. BASHKËPUNIMI ME POLICINË
25. BASHKPUNIMI I IPK-së ME SHÇBA-ne NGA SHQIPËRIA
26. KONFERENCA E 15-të E EPAC-ut (EUROPEAN PARTNERS AGAINST CORRUPTION – PARTNERËT EVROPIAN KUNDËR KORRUPCIONIT)
27. KONGRESI EVROPIAN I TEKNOLOGJISË LIGJORE 2015 (LAW TECH EUROPE CONGRESS 2015)
28. SEMINARI NËRKOMBËTAR PËR MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN E POLICISË
29. PROJEKTI I BINJAKZIMIT “FUQIZIMI I KAPACITETEVE PËR HETIME PENALE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPCIONIT”
30. BASHKPUNIMI I IPK-së ME EULEX-in DHE OSBE-ne



MISIONI I IPK-SË

MISIONI I INSPEKTORATIT POLICOR TË KOSOVËS ËSHTË QË PËRMES USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË TIJ, TË SIGUROJË NJË SHËRBIM POLICOR TË PËRGJEGJSHËM, DEMOKRATIK DHE TRANSPARENT, NË PËRPTHJE ME LEGJISLACIONIN NË FUQI DHE STANDARDET E KËRKUARA.



Pamje e personelit të Inspektoratit Policor të Kosovës

Ofrimi i shërbimit të IPK-së sa më afër çdo qytetari të vendit do të vazhdoj të jetë prioritet i yni



Skender Hyseni - Ministër i Punëve të Brendshme

Inspektorati Policor i Kosovës, gjatë vitit 2015 sipas misionit të tij, ka fuqizuar mëtej Policinë e Kosovës, e cila pa asnjë mëdyshje është policia më e mirë në rajon, dhe e krahasueshme çdo e ditë e më shumë edhe me policitë e disa prej vendeve të BE-së.

Ruajtja e këtij imazhi të mirë të policisë sonë dhe fuqizimi i besimit të publikut në të, kërkon edhe avancim të kapaciteteve brenda Inspektoratit Policor të Kosovës, si në resurse

njerëzore ashtu edhe në avancimin e pajisjeve për realizimin e veprimtarisë.

Andaj, si Ministër i MPB-së, do të angazhohem maksimalisht për shtimin e personelit hetues dhe inspektues në IPK, si dhe sigurimin e pajisjeve sa më moderne me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit, gjatë ushtrimit të autorizimeve të IPK-së.

Do të angazhohem edhe më tutje për sigurimin e trajnimeve me qëllim të adoptimit të teknikave sa më të avancuara, në fushën e hetimit penal për punonjësit operativ në IPK, në mënyrë që veprimtaria e hetimeve penale e IPK-së të kryhet sa më drejt dhe me shpenzime sa më racionale.

Gjatë vitit 2015, IPK-ja ka shtrirë shërbimin edhe në tri Komuna të tjera si: Gjilan, Prizren dhe Mitrovicë të Veriut, me qëllim që qytetarëve tonë, t'ju ofrohet mundësia për denoncimin e veprimeve të pandërgjegjshme të çdo punonjësi të Policisë së Kosovës.

Gjatë këtij viti, ne synojmë hapjen edhe të zyrave tjera rajonale të IPK-së, me qëllim që ky shërbim të jetë sa më afër qytetarëve të vendit.

Do të bashkërendojmë edhe më tutje bashkëpunimin e IPK-së me agjencitë dhe institucionet e tjera të vendit.

Do të promovojmë edhe më tutje fuqizimin e bashkëpunimit të mëtejshëm të IPK-së me Policinë e Kosovës si dhe me Prokurorinë e Shtetit, duke u përpjekur për një bashkëpunim të mirëfilltë dhe të sinqertë për të arritur rezultatet e pritura, dhe për të përmbushur misionin e këtij institucioni të rëndësishëm për sundimin e ligjit në vend.

Prioritet i yni do të jetë bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet homologe të rajonit, Evropës dhe të SHBA-ve.

Si Ministër i Punëve të Brendshme, në mars të vitit të kaluar, në mbledhjen e përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nga katër marrëveshjet e nënshkruara në fushën e rendit dhe të sigurisë, ishte edhe memorandum i bashkëpunimit për forcimin e kontrollit të brendshëm, në mes të dy Ministrive homologe.

Potencoj se, do të vazhdoj të fuqizoj dhe të thelloj edhe më tej bashkëpunimin ndërkombëtar të IPK-së, përmes arritjes së marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit, për të realizuar bashkëpunimin në praktikë, sidomos në shpërndarjen e informacioneve për të kontribuar në parandalimin e veprimeve individuale të pandërgjegjshme të punonjësve të policisë sonë, me punonjësit e policisë së rajonit dhe më gjerë.

Disiplina dhe serioziteti i punës brenda vetë IPK-së, do të jetë në mbikëqyrje të vazhdueshme nga unë dhe nga ekipi im në Ministrinë time.

Për këtë qëllim kam autorizuar njërin nga zëvendësministrat e MPB-së, që në përditshmërinë e punës së tij, ta mbuloj edhe mbikëqyrjen e funksionimit të IPK-së dhe të më raportoj në baza të rregullta për problemet, kërkesat dhe shqetësimet që mund të ketë brenda këtij institucioni.

Do të analizojmë me kujdes të shtuar epilogun e rasteve të ngritura nga IPK-ja, duke mos lejuar asnjë ndërhyrje nga jashtë.

E gjithë kjo që të sigurohem që profesionalizmi dhe transparenca brenda IPK-së të vazhdoj të mbetet evidente.

Me këtë rast, dua të falënderoj ICITAP-in amerikan, i cili ka qenë dhe është gjithmonë pranë MPB-së, në veçanti pranë IPK-së, OSBE-në, EULEX-in dhe DCAF-in për mbështetjen e vazhdueshme të IPK-së.

Më lejoni që në fund të falënderoj të gjithë zyrtarët e IPK-së, dhe t'i siguroj ata se do të jem gjithmonë pranë dhe në mbështetje të tyre.

2. FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV



Kryeshefi Ekzekutiv z. Fitim Shishani

Të nderuar lexues, si çdo herë edhe këtë vit jam shumë i lumtur që kam mundësinë të ju drejtohem në këtë formë, si Kryeshef i Inspektoratit Policor të Kosovës, duke pasqyruar për ju raportin vjetor të IPK-së për vitin 2015. Nderin tim të madh për të komunikuar me ju, këtë vit e konfirmon edhe një fakt i rëndësishëm për institucionin që unë e kryesoj, e që është shënimi i dhjetë (10) vjetorit të formimit dhe zhvillimit të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Viti 2006 shënon krijimin e IPK-së, si mekanizëm mbikëqyrës ndaj punës së Policisë sonë. Që nga themelimi e gjerë më sot, rrugëtimi i IPK-së ka qenë i vështirë, sidomos: për krijimin e një imazhi kaq pozitiv që sot e gëzojmë në shoqërinë kosovare, për të arritur realizimin në tërësi të objektivave strategjike që i kishim përcaktuar vetes sonë, për të merituar kujdesin, trajnimet dhe këshillat nga shumë organizata profesionale ndërkombëtare si: ICITAP-i Amerikan, OSBE, DCAF, EULEX etj, pastaj, për të qenë lider në zbatimin e mandateve tona ligjore dhe sidomos, për të gëzuar besimin dhe respektin e qytetarëve tanë.

Është e natyrshme që secili institucion në shtetin tonë, në fillim të krijimit, ka pasur vështirësitë dhe sfidat e veta. IPK-ja arriti me kohë rekorde ta tejkaloj çdo pengesë të mundshme në rrugëtimin e saj. Ishte OSBE-ja që deri në vitin 2011, jo vetëm si themeluese, por edhe në forma tjera, si trajnime etj, u kujdes që kompetencat e Inspektoratit Policor të ushtrohen drejt dhe profesionalisht. Të gjithë punonjësit e IPK-së dhe menaxhmenti gjithashtu, i janë mirënjohës OSBE-së për kontributin e dhënë.

Zhvillim të madh për IPK-në, në çdo sferë, shënon 1 qershori i vitit 2011. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.03/L 231, kompetencat për Inspektoratin Policor zgjerohen, duke i bërë të mundur hetuesve tanë, të zhvillojnë hetime penale ndaj personelit policor për veprat penale të supozuara, të cilat ata mund t'i kryejnë. Sot kur po shënojmë *dhjetë vjetorin* e ekzistencës sonë, lirshëm, konfirmojmë kënaqësinë tonë, sa i përket zhvillimit të hovshëm që bëri IPK-ja. Ne edhe njëherë rikujtojmë, se misioni ynë ka qenë dhe do të mbetet, ti kryejmë detyrat tona, ti zbatojmë mandatet tona ligjore, të vazhdojmë të jemi *të përgatitur, profesional dhe objektiv*, sepse, vetëm kështu do t'i sigurojmë Kosovës një polici të përgjegjshme, demokratike dhe transparente.

Ne shprehemi të bindur, se një zhvillim kaq i lartë i IPK-së, nuk do të arrihej në asnjë mënyrë pa respektimin e ligjshmërisë, si: Kushtetutës së Kosovës, Ligjit të IPK-së, kodit penal, kodit të procedurës penale si dhe kodit etik të IPK-së. Duke vepruar në këtë mënyrë, Inspektorati Policor i Kosovës, arriti shpejt të kaloj fazën e konsolidimit në qendër, duke u shtrirë në tri rajone të Kosovës gjerë më sot. Sot ne kemi në pune aktivisht, zyrat tona në: Gjilan, Prizren dhe në Mitrovicën e Veriut. I përgëzoj punonjësit e mi, për angazhimin e tyre, sepse, këto zyre, u hapen vetëm me përkushtimin e tyre. Ndërsa për sigurimin e lokaliteteve i falënderohemi menaxhmentit të ARC-së, dhe komunave përkatëse. Të dashur qytetarë të Kosovës, në brendi të raportit ju do të informoheni shumë më hollësisht për sfidat dhe të arriturat e IPK-së. Ne konfirmojmë edhe një herë, përcaktimin tonë, se do të jemi shumë afër policisë sonë, për t'i ndihmuar në realizimin e objektivave të tyre, sikurse do të punojmë shumë që të parandalojmë dhe luftojmë çdo dukuri negative dhe të rrezikshme brenda policisë, sidomos korrupsionit, në mënyrë që të kontribuojmë në profesionalizmin, humanizmin, objektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien edhe më të madhe të policisë sonë, si një ndër policitë më të mira në rajon. Ne kemi bindjen e plotë se do të ruajmë epitetin si një institucioni i përgatitur, profesional e objektiv në punën tonë. Do të vazhdojmë të shërbejmë me etikë profesionale, me sjellje dhe komunikim të kulturuar, duke menduar çdo herë për të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Të ndodhur në këtë pozitë të profesionalizmit, dua që nga zemra, në emër të të gjithë punonjësve të IPK-së dhe në emrin tim, t'i falënderohem të gjithë atyre që me angazhimin e tyre e sollën IPK-në në këtë nivel zhvillimi profesional, sidomos ICITAP-in Amerikan, që ishte faktori kryesor në zhvillimin tonë institucional, pastaj OSBE-në, EULEX-in, DCAF-in, etj.

IPK-ja do të dëshmojë çdo herë se ishte storie e përbashkët e suksesit.


Falemnderit !

3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E IPK-së

Inspektorati Policor i Kosovës funksionet i ka zhvilluar përmes departamenteve operative që janë: Departamenti i Hetimeve, Departamenti i Inspektimeve, Departamenti i Hetimeve Speciale dhe Departamenti për Shqyrtimin dhe Menaxhimin e Ankesave. Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme përmes aktiviteteve të saj ka mbështetur funksionimin e departamenteve operative.

Inspektorati Policor i Kosovës aktivitetin e saj e ka zhvilluar me burime njerëzore të kufizuara me gjithsej 44 hetues, 12 inspektorë dhe 16 personel mbështetës, gjithsej 73 punonjës.

Struktura organizative e IPK-së



4. SFIDAT DHE TË ARRITURAT KRYESORE TË IPK-së GJATË VITIT 2015

Plani Strategjik i IPK-se 2012-2015 ishte udhërrëfyese për drejtimin e IPK-së sa i përket arritjes së qëllimeve dhe objektivave të këtij plani.

Në këtë Plan Strategjik janë përfshirë një numër i qëllimeve dhe objektivave strategjike që për IPK-në janë manifestuar në një spektër sfidash duke përfshirë çështje nga kushtet e punës deri tek fuqizimi i komunikimit me qytetarë dhe institucione tjera që ndërlidhën me mandatin e IPK-së. IPK ka arritur sukses domethënës në arritjen e këtyre qëllimeve dhe objektivave.

Gjatë vitit 2015, një ndër sfidat kryesore dhe e vazhdueshme e IPK-së, e identifikuar edhe në Planin Zhvillimor Strategjik ishte vendosja dhe ruajtja e standardeve profesionale në zbatimin e mandateve ligjore të IPK-së si dhe ofrimi i shërbimeve sa me afër qytetarëve.

Hartimi dhe implementimi i fazës së parë të projektit të regjionalizimit të IPK-se ka bërë që të krijohet një sistem i brendshëm i kontrollit dhe cilësisë më kualitative në raport me shërbimet që IPK ofron për qytetarët.

Funksionalizimi i tri zyrave regjionale (Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë e Veriut) ka krijuar më shumë mundësi për qytetarët ,policinë dhe IPK-në për të qenë më efektiv në aspektin e komunikimit të ndërsjellë.

Rishikimi i udhëzimeve administrative të IPK-së, i paraparë me Planin Legjislativ të MPB-së, ishte një sfidë të cilën IPK ka arritur që ta tejkaloj me sukses duke kryer rishikimin e katër (4) udhëzimeve administrative dhe në afatin e paraparë t'i dërgoj në zyrën ligjore të MPB-së për miratim të Ministri.

Jetësimi i këtyre udhëzimeve administrative ka rezultuar me ngritjen e llogaridhënies menaxheriale, qartësinë funksionale të departamenteve dhe në forcimin e disiplinës dhe menaxhimit me të mirë të burimeve njerëzore.

Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore të IPK-së përmes trajnimeve profesionale të avancuara të cilat ishin ofruar kryesisht nga ICITAP-i Amerikan, ka mundësuar që efikasiteti i IPK-së në parandalimin dhe hetimin e veprave të korrupsionit në Policinë e Kosovës të jetë në ngritje të vazhdueshme.

IPK ka vazhduar të sigurojë shërbime më të mira dhe të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës, qytetarët, akterët-partnerët e saj të brendshëm dhe të jashtëm, gjatë zbatimit të mandateve të saj ligjore, duke ofruar shërbime të cilat ishin të kompletuara, korrekte, të kujdesshme, të kryera me përkushtim dhe mirësjellje.

IPK ka arritur që edhe këtë vit të fuqizoj besimin e saj tek Policia e Kosovës përmes hetimeve dhe inspektiveve kualitative me veprime dhe rekomandime konkrete. IPK ka arritur që me sukses të trajtojë të gjitha ankesat e pranuar dhe me një efikasitet të lartë t'i përcjellë në Policinë e Kosovës apo Prokurori për trajtim të mëtutjeshëm. Ky fuqizim i besimit është theksuar edhe te qytetarët e Kosovës pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike apo religjioze e cila është dëshmuar me transparencën dhe korrektësinë përmes publikimit të raporteve të inspektiveve dhe cilësisë së hetimeve.

IPK-ja vazhdimisht e ka njoftuar akteret relevant vendimmarrës lidhur me aktivitetet hetimore dhe për të gjeturat nga inspektimet e ndërmarra si dhe vazhdimisht ka informuar qytetarët dhe grupet e interesit, duke treguar transparencë dhe gatishmëri për të punuar edhe me të tjerët të cilët ndajnë të njëjtin vizion për të pasur një polici profesionale dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve të saj.

5. SHEMBULLI I SUKSESIT NË IPK-së

Divizioni për komunikim me publikun dhe bashkëpunim vendor e ndërkombëtar



Figure 1. Pamje nga takimet me qytetarët dhe partnerët e IPK-së nëpër komunat e Kosovës

Divizionit për komunikim me publikun dhe bashkëpunim ndërkombëtar (DKPBN) i IPK-së, gjatë vitit 2015 ishte shembull i suksesit në angazhimin e përhershëm të IPK-së në fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë.

Puna e këtij divizioni ka përfshirë shumë aktivitete në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe bashkëpunim vendor e ndërkombëtar me synim që të fuqizohet bashkëpunimi me qytetarët dhe me institucionet vendore e ndërkombëtare në Kosovë dhe jashtë saj në drejtim të zbatimit të mandatit ligjor të IPK-së.

Sfida dhe sukcesi kryesor i këtij divizioni ishte në zbatimin e suksesshëm të organizimit dhe kordinimit të shumë takimeve, seminareve, konferencave, video-spotëve, komunikatave, shkëmbimit të informacioneve në mes IPK-së dhe qytetarëve, organizatave vendore dhe ndërkombëtare, ekspertëve dhe udhëheqësve të ndryshëm vendore dhe ndërkombëtare lidhur me punën e përditshme të IPK-së.

Disa prej aktiviteteve që ky Divizion i IPK-së ishte i angazhuar drejtpërsëdrejti në vitin 2015 ishin: realizimi me sukses i fazës së parë të projektit “Regjionalizimi dhe fuqizimi i IPK-së”(angazhimet për gjetjen e lokacioneve dhe hapjen e tri zyrave rajonale të IPK-së në Gjilan, Prizren dhe Mitrovicën e Veriut), aktivitete për prezantimin e fushë-veprimtarisë së IPK-së para qytetarëve të Kosovës, në komuna të ndryshme në kuadër të forumeve të sigurisë, shumë aktivitete në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe transparencës, promovimi i “Linjës së kaltër”, trajtimi i kërkesave për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, kontakte dhe takime me organizatat si motra nga vendet rajonale dhe draftimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, organizimi i dy seminareve ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes së policisë (në bashkëpunim me DCAF-in dhe departamentet tjera të IPK-së), publikimi i revistës “Integriteti” etj.

Fuqizimi i bashkëpunimit me qytetarë dhe përmirësimi i shërbimeve drejt qytetarit të vendit ka ndikuar pozitivisht në realizimin e misionit ligjor të IPK-së drejt një policie sa më profesionale, efektive dhe efikase, drejt një policie me integritet të lartë dhe me kredibilitet.

6. 10 VJET NGA THEMELIMI I INSPEKTORATIT POLICOR TË KOSOVËS



Figure 2. Gjenerata e parë e Inspektorve të IPK-së së bashku me Ekipin Zbatues të themelimit të IPK-së nga OSBE në vitin 2006

Ishte viti 1999 kur lufta e qytetarëve të Kosovës për pavarësi përfundoi dhe Kosova ishte e lirë duke kaluar në protektorat ndërkombëtar nën administrimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë-UNMIK.

Si një vend i posa dalë nga lufta, qytetarët e Kosovës në bashkëpunim me administratën e UNMIK-ut, si qëllim parësor kishin rindërtimin e Kosovës duke përfshirë edhe ngritjen e institucioneve të saj vet-qeverisëse.

Një ndër institucionet e para që ishin themeluar ishte edhe Policia e Kosovës (atëherë Shërbimi Policor i Kosovës) që u krijua me 06/09/1999 e cila filloj të rekrutojë dhe trajnoj gjeneratat e para të zyrtarëve policorë sipas koncepteve demokratike të policimit.

Në vitin 2005-2006 nga PSSP (Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm) të OKB-së kishte lëshuar rregullore të veçanta për të hapur rrugën për të themeluar Inspektoratin Policor të Kosovës si një mekanizëm mbikëqyrës i policisë, i pavarur nga Policia e Kosovës.

Korniza ligjore për Inspektoratin Policor të Kosovës përbëhej prej Rregullores 2005/54, nenit 9 (mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës) dhe Urdhresës Administrative 2006/9 „Shtojca A ku thuhej;

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të themelojë Inspektoratin Policor të Kosovës për:

- a) Kryerja e auditimeve dhe inspektimeve të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të raportojë për performancën e saj dhe efikasitetin në arritjen e objektivave; dhe
- b) Hetojë akuzat se policët ose anëtarët civilë të Shërbimit Policor të Kosovës kanë kryer shkelje të rënda disiplinore, dhe të rekomandojë për Këshillin për Emërime të Larta Policore dhe Disiplinë (KELPD), nëse ka sanksion disiplinor që duhet të imponohen.

Inspektorati Policor i Kosovës parashihej të themelohej si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishte paraparë të ishte i pavarur nga Shërbimi Policor i Kosovës dhe personeli i saj dhe burimet materiale nuk do të konsideroheshin si personel dhe burime materiale të Shërbimit Policor të Kosovës; IPK do të veprojë në mënyrë profesionale dhe të paanshme, duke respektuar plotësisht standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të lirë nga ndërhyrjet e panevojshme politike, dhe në interes të të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Në shtator të vitit 2005, ishte bërë një marrëveshjeje ndërmjet Shefit të Shtyllës së I-rë të UNMIK-ut dhe ambasadori i OSBE , Z. Werner Wnendt për themelimin e IPK-së. Një ekip i vogël i stafit të OSBE-së ishte nxjerr nga Departamenti i Arsimit dhe Zhvillimit të Policisë (DZHEP) dhe kishte formuar Ekipin Zbatues për themelimin e IPK-së.

Që në fillim Ministria e Punëve të Brendshme, e sapo themeluar, kishte autoritet të plotë ekzekutiv për IPK-në, ndërsa OSBE-ja ofrojnte një gamë të gjerë të masave mbështetëse për të lejuar këtij institucioni të ri të fillojë punën sa më shpejt.

Përderisa ndërtimi i kapaciteteve do të formojë thelbin e kësaj përpjekjeje, Ekipi Zbatues i IPK-së kishte përgatitur buxhetin e vitit 2006 ndërsa stafi i Ministrisë së MPB-së kishte ushtruar autoritetin ekzekutiv në lidhje me përzgjedhjen e stafit për IPK, blerjen e automjeteve , pajisjet për zyre dhe një ndërtesë me qira. Po ashtu, struktura organizative e IPK-së, përshkrimet e punës , Procedurat Standarde Operative dhe dokumente të tjera të përgatitura nga ana e OSBE-së dhe janë përdorur vetëm pasi ato janë miratuar nga Ministri i MPB-së.

Pjesa më e madhe e përpjekjeve të OSBE-së ishte fokusuar në hartimin dhe zhvillimin e një programi të plotë për ndërtimin e kapaciteteve në dy faza. Ai ishte vendosur për të ndarë IPK- në dy grupe, secila me funksione të specializuara që përgjigjej për rolet proaktive dhe reaktive , siç përcaktohet në Rregulloren 2005/54 dhe Urdhëresës Administrative 2006/9 .

Duke e ditur se pa besim dhe bashkëpunim aktiv të personelit të SHPK-së dhe IPK-së nuk mund të kishte shpresë për sukses, Ekipi i Zbatimit kishte hartuar një program që shumë shpejt të zhvillohej dhe të ruhej një marrëdhënie efektive pune me SHPK-në. Prandaj, ishte vendosur për të zgjedhur dhe për të trajnuar stafin e IPK-së në dy faza.

Zhvillimi dhe zbatimi i një kuadri të shëndoshë ligjore për Inspektoratin Policor të Kosovës, ishte padyshim i rëndësishëm për suksesin e saj.



Figure 3. Gjenerata e parë e Inspektorve të IPK-së gjatë trajnimit Intenziv gjashtmuorë nga OSBE gjatë vitit 2006.

Në fazën e parë, ekipi i IPK-së do të trajnohen në funksion **proaktive** dhe, pasi kjo të ishte kryer me sukses, një grup i dytë do të rekrutohej dhe trajnohej në funksion **reaktive**.

Në fazën e parë u rekrutuan fillimisht 20 inspektor që u trajnuan në funksionin **proaktiv**. Me këtë qasje synohej ndërtimi i besimit të stafit të IPK-së tek të inspektuarit- Policia, përmes punës më pak konfrontuese siç ishte inspektimi, si dhe të lejojë që ata të zhvillojnë njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e organizatës së SHPK-së. Në fazën e dytë u rekrutuan edhe 20 hetues që u trajnuan në funksionin **reaktiv** të cilët do të merren me ankesat kundër policëve që mund të vënë në dyshim besueshmërinë e hetuesve në një hetim disiplinor.

Bazuar në qasjen e "të mësuarit-aktiv" për arsimimin e të rriturve, programi ndërtimi i kapaciteteve të OSBE-së kishte projektuar për të operacionalizuar IPK brenda disa javësh. Kështu, në Fazën e Parë të Programit gjashtë muajsh, zyrtarët e IPK-së kanë alternuar midis periudhave të punës në klasë dhe punës në terren operacional. Në mënyrë tipike, rekrutët e rinj do të kalojnë një javë në klasë duke studiuar aftësitë e raportimit me shkrim, të ligjeve të zbatueshme dhe të teorisë dhe praktikës menaxheriale, duke ndjekur parimin nga të mësuarit e thjeshtë në të mësuarit kompleks.

Në të gjitha këto fusha kryesore janë përcjell me vlerësime individuale, testime me shkrim në kurset e rregullta dhe provime formale. Të trajnuarit e IPK-së janë monitoruar nga afër nga stafi i OSBE-së, për të siguruar se punët janë kryer në përputhje me ligjin dhe kanë demonstruar integritetin, profesionalizëm dhe qëndrimet të tjera thelbësore të IPK-së.

Në vitin 2008 Kosova finalizon vullnetin e përhershëm të qytetarëve të saj duke shpallur pavarësinë dhe duke miratuar kushtetutën e saj si një shtet i pavarur demokratik me një sistem parlamentar të qeverisjes dhe duke zëvendësuar rregulloret e UNMIK-ut me ligje të nxjerra nga përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Një ndër këto ligje ishte edhe ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Ky ligj kishte pothuajse të njëjtën përmbajtje sikurse edhe rregullorja e UNMIK-ut me disa ndryshime të cilat fuqizonin IPK-në si një mekanizëm i jashtëm i mbikëqyrjes policore i pavarur nga Policia e Kosovës e cila kishte mandat inspektimin e strukturave policore dhe hetimin disiplinor të shkeljeve të lehta dhe të rënda të pjesëtarëve të tyre ku kishte një këshill të lartë për disiplinë policore i cili ishte i përbërë nga shërbyes civil nga administrata shtetërore të cilat i gjykonin rastet e shkeljeve disiplinore të policëve të hetuara nga IPK-ja.

Kjo fazë përbën edhe kohën e zhvillimit profesional të IPK-së në aspektin e përvojës në drejtim të pjekurisë institucionale përmes mandateve të saj duke u përkujdesur që Policia e Kosovës kryen detyrat dhe përgjegjësitë e saj konform Kodit Evropian të Etikës Policore.

Në vitin 2010, IPK pas një analize të punës dhe mandateve të saj, kishte arritur në përfundim se hetimi i vetëm shkeljeve disiplinore të policëve pa përfshirë edhe ato penale, të cilat deri në atë kohe ishin ende në mandatin e Policisë së Kosovës që të hetonin vetveten në aspektin penal, nuk ishte e mjaftueshme. Prandaj, me përkrahjen MPB-së e edhe të partnerëve ndërkombëtare siç ishte ICITAP (Departamenti i Drejtësisë, Ambasada e SHBA-së Kosovë), OSBE, EULEX, EU etj, u vendos që ligji për IPK-në të rishikohet dhe të amendamentohet.

Qëllimi kryesor i këtij rishikimi ishte në atë që IPK të merrte edhe mandatin shtesë që të hetonte edhe shkeljet e punonjësve të Policisë që përbënin vepër penale me Kodin Penal të Kosovës si dhe personeli operativ i IPK-së të ketë autorizime policore.

Në dhjetor të vitit 2010 pas miratimit në Kuvendin e Kosovës ky ligj hyri në fuqi duke i dhënë IPK-së mandatin për hetime penale ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës.

Gjatë viteve 2010-2015, IPK kishte hyre në fazën e pjekurisë së plotë duke nxjerr të gjitha aktet nënligjore përcjellëse të ligjit të ri, duke hartuar planin e saj zhvillimor strategjik, duke dyfishuar numrin e personelit të saj operativ, duke punuar në mënyrë intensive për ngritjen e vizibilitetit të organizatës tek qytetarët përmes një komunikimi proaktiv përmes komunikatave, ligjëratave, konferencave, video dhe radio spoteve, duke ofruar shërbimet më afër qytetarëve përmes numrit falas të telefonit, kontaktit përmes internetit, iniciativës së hapjes së zyrave regjionale.

Trajnimet e shpeshta të ofruara nga ICITAP në fusha të hetimeve të avancuara penale dhe në inspektime nga agjencitë më të njohura botërore të zbatimit të ligjit siç ishin Departamenti i Policisë së Los Anxhelos, Universiteti Northwest, prokuror të ndryshëm federal nga SHBA, Marina Amerikane etj. Të gjitha këto trajnime të ofruara nga ICITAP kishin bërë që profesionalizmi në IPK, sa i përket mandateve hetimore dhe inspektuese të jenë të standardeve më të larta.

IPK sot është pjesë e shumë nismave dhe organizatave ndërkombëtare të mbikëqyrjes policore siç është EPAC si dhe përfaqëson Kosovën në të gjitha nismat ndërkombëtare dhe rajonale lidhur me mekanizmat mbikëqyrës të policisë si shembull suksesi edhe për të tjerët.

7. PARTNERITETI I IPK-së ME ICITAP-in AMERIKAN

IPK vlerëson lart bashkëpunimin me ICITAP-in Amerikan i cili është i rëndësishë së veçantë dhe ka karakter shumë dimensional. Ky bashkëpunim, përveç natyrës këshillëdhënëse dhe mbështetëse, ka ndihmuar IPK-në edhe në ndërtimin e kapaciteteve .

IPK, sikurse edhe viteve të kaluara edhe në vitin 2015 ka përfituar nga ICITAP-i trajnime konkrete nga fushat e nevojshme për ngritjen e cilësisë së punës në IPK dhe për të kryer mandatet dhe misionin e IPK-së me një kualitet të lartë.



Figure 4. Personeli i ICITAP-it Amerikan- partner kryesorë në zhvillimin e IPK-së

Takimet e rregullta të menaxhmentit të IPK-së me përfaqësuesit e kësaj organizate, përkushtimi dhe puna e tyre e pa lodhshme, ka bërë që IPK-ja të njihet si organizatë e cila dëshmon para qytetarëve të saj dhe të tjerëve se është një organizatë e trajnuar mirë, e përgatitur për t'u ballafaquar me sfida, dhe objektive për të kërkuar të vërtetën gjatë ushtrimit të funksioneve të saj. Sikurse edhe vitet tjera, ICITAP, edhe këtë vit ka mbetur si organizata më përkrahëse për IPK-në.

Vlen të përmendet kontributi i kësaj organizate në ofrimin e këshillave dhe ekspertizës në nxjerrjen dhe rishikimin e udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për IPK-në, dhe draftimit të Procedurave Standarde të Operimit duke ndarë me qartësi detyrat dhe përgjegjësitë e IPK-së të cilat garantojnë efikasitet dhe ngritje të cilësisë së punës së IPK-së.

Trajnimet të cilat i ka ofruar këtë vit ICITAP-i për IPK-në kanë qenë të pazëvendësueshme në ngritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të IPK-së duke ofruar programe dhe ekspertët më të mirë në fushën e zbatimit të ligjit. Trajnimet të cilat ka ofruar ICITAP ndër vite për IPK-në kanë qenë mese të nevojshme dhe të qëlluara për të arritur përmbushjen e misionit të IPK-së.

Ndër trajnimet e rëndësishme të realizuara gjatë 2015-ës ishin trajnimet për “Aspektet legale të luftimit të Korrupsionit” dhe “Trajnimi i Hetimit të Narkotikëve”shih tabelën si më poshtë).

Ekspertët nga ICITAP-i kanë treguar gatishmëri të plotë në mbështetjen e vazhdueshme për të dhënë këshillat e nevojshme duke qenë të përkushtuar në ofrimin e praktikave të vendeve të tyre, të cilët kanë pasur suksese të dukshme në luftën kundër korrupsionit dhe keq menaxhimit policor. Duke parë një gatishmëri për bashkëpunim nga ana e kësaj organizate, IPK-ja ka vendosur në njërin nga objektivat strategjike të saj bashkëpunimin e vazhdueshëm me këtë organizatë.

Një ndër projektet me të cilin është IPK-ja përkrahur nga ICITAP është RIMS-i (Sistemi për Menaxhimin e Burimeve të Informacionit. Ky projekt është implementuar nga Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetime Penale (ICITAP). Sistemi për Menaxhimin e Burimeve të Informacionit (RIMS), ndihmon në përmbushjen e qëllimeve strategjike për rritjen e efikasitetit, llogaridhënies dhe

transparencës në IPK. Ky sistem digjitalizon proceset e brendshme dhe e bën të mundur, e-qeverisjen në MPB dhe agjencitë e saj.

Tabela nr.12: Trajnimet e punonjësve të IPK nga ICITAP 2011-2015

TRAJNIMET E OFRUARA NGA ICITAP-I AMERIKAN PËR IPK-në GJATË VITEVE 2011-2015		
	Lloji i trajnimit	Organizata
1.	Trajnimi mbi teknikat e marrjes ne pyetje dhe intervistimit	ICITAP
2.	Kursi bazik i hetimeve penale	ICITAP
3.	Trajnimi bazik mbi procesin e inspektimit	ICITAP
4.	Teknikat e analizës financiare	ICITAP
5.	Ngacmimi seksual dhe armiqësia ne punë	ICITAP
6.	Shkolla për Personel Policor dhe Komandim	ICITAP
7.	Kursi i Avancuar për Mbledhjen e Dëshmive	ICITAP
8.	Kursi Bazik për Auditimin e Performancës së Zbatimit të Ligjit	ICITAP
9.	Kursi për Vëzhgim dhe Informator Konfindencial	ICITAP
10.	Shkolla për Personel Policor dhe Komandim	ICITAP
11.	Kursi i Hetimit të Përfshirjes së Zyrtarit Policor ne Gjuajtje me Armë	ICITAP
12.	NCIS/ Seminari i Asistencës Teknike-Kosovë	ICITAP
13.	Analizat e Avancuara të Larjes së Parave	ICITAP
14.	Kursi i Auditimit te Performances	ICITAP
15.	“Trajnimin për teknikat e avancuara të intervistimit dhe të shkrimit të raporteve”	ICITAP
16.	Hetimi i përbashkët i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore	ICITAP
17.	Ndryshimet e Kodit penal dhe atë të Procedurës Penale	ICITAP
18.	Teknikat e avancuara të hetimeve financiare	ICITAP
19.	Hetimet e brendshme- kurs i avancuar	ICITAP
20.	Kursi i gjuhës angleze	ICITAP
21.	Teknikat e hetimit të krimeve kompjuterike	ICITAP
22.	Kursi i gjuhës angleze	ICITAP
23.	Trajnim për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale	ICITAP
24.	Kursi i hetimit të vrasjes	ICITAP
25.	Shkolla e Stafit Policor dhe komandës	ICITAP
26.	Trajnimi i Hetimit të Narkotikëve	ICITAP
27.	Aspektet legale të luftimit të Korrupsionit	ICITAP

8. TRAJNIMET e IPK-së NDËR VITE 2011-2015

TRAJNIMET E OFRUARA PËR IPK-në GJATË VITEVE 2011-2015		
	Lloji i trajnimit	Organizata
1.	Trajnimi mbi teknikat e marrjes ne pyetje dhe intervistimit	ICITAP
2.	Kursi bazik i hetimeve penale	ICITAP
3.	Trajnimi bazik mbi procesin e inspektimit	ICITAP
4.	Teknikat e analizës financiare	ICITAP
5.	Ngacmimi seksual dhe armiqësia ne punë	ICITAP
6.	Shkolla për Personel Policor dhe Komandim	ICITAP
7.	Kursi i Avancuar për Mbledhjen e Dëshmimeve	ICITAP
8.	Kursi Bazik për Auditimin e Performancës së Zbatimit të Ligjit	ICITAP
9.	Kursi për Vëzhgim dhe Informator Konfidencial	ICITAP
10.	Shkolla për Personel Policor dhe Komandim	ICITAP
11.	Kursi i Hetimit të Përfshirjes së Zyrtarit Policor ne Gjuajtje me Armë	ICITAP
12.	NCIS/ Seminari i Asistencës Teknike-Kosovë	ICITAP
13.	Analizat e Avancuara të Larjes së Parave	ICITAP
14.	Kursi i Auditimit te Performances	ICITAP
15.	Menaxhimi dok. zyrtare, protokollimi, arkivimi dhe procedura e qasjes ne dok. zyrtare	FLSA
16.	Kursi i Riqertifikimit	AKSP
17.	Trajnimi ne procedurat e Prokurimit dhe Tenderve	OSBE
18.	Trajnimi ne dizajnimin e korikulave- Faza e Pare	OSBE
19.	Klasifikimi I vendeve të punës/Rregullorja nr.05/2012	IKAP
20.	Moduli I Blerjeve/Zyrtari I Pranimit të mallit	MEF
21.	Menaxhimi dhe zhvillimi I burimeve njerzore	OSBE
22.	Ligji për Sherbimin Civil të Rep. Kosovës/ Rregulloret nr.04/2010, 05/2010, 06/2010	IKAP
23.	Buxheti, decentralizimi I shpenzimeve dhe menaxhimi I financave publike	FLSA
24.	“Trajnimin për teknikat e avancuara të intervistimit dhe të shkrimit të raporteve”	ICITAP
25.	Hetimi i përbashkët i rasteve të trafikimit me qenie njerzore	ICITAP
26.	Ndryshimet e Kodit penal dhe atë të Procedurës Penale	ICITAP
27.	Teknikat e avancuara të hetimeve financiare	ICITAP
28.	Hetimet e brendshme- kurs i avancuar	ICITAP
29.	Kursi i gjuhës angleze	ICITAP
30.	Detyrat e veçanta kriminalistike	RH
31.	Kursi i Riqertifikimit	AKSP
32.	Ngritja e nivelit profesional të IPK-së	KONTO-Veb
33.	Moduli I Blerjeve/Zyrtari I Pranimit të mallit	MEF
34.	Teknikat e hetimit të krimeve kompjuterike	ICITAP
35.	Kursi i gjuhës angleze	ICITAP
36.	Trajnim për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale	ICITAP
37.	Kursi i hetimit të vrasjes	ICITAP
38.	Shkolla e Stafit Policor dhe komandës	ICITAP
39.	Hetimi i krimt qe kanë kanë të bëjnë me prokurimin publik	B&C
40.	Ngritja e nivelit profesional të IPK-së	KONTO-Veb
41.	Udhëheqja e hetimeve të krimeve financiare	B&C
42.	Trajtimi i thirrjeve në IPK	IPK
43.	Procedurat Administrative	IKAP
44.	Etika dhe anti-korrupcioni ne administraten publike	IKAP
45.	Funksionimi i Administrates Shtetrorre ne RK	IKAP
46.	Vlersimi i rezultateve të punës në SHC	IKAP
47.	Standardizimi i vendeve të punës	IKAP
48.	Planifikimi i personelit	IKAP
49.	Procesi i vetëvlerësimit në organizatë	IKAP
50.	Trajnimi i përgjithshëm për hetimin e krimt të organizuar	UE
51.	Hetimi bazik financiar	MPB
52.	Puntori për Mentorim dhe Internship	OSCE
53.	Legal Aspectes of Combating Corruption	ICITAP
54.	Aspekte Ligjore te luftimit të korrupsionit	UE
55.	Trajnimi i Hetimit të Narkotikëve	ICITAP
56.	Trajnim, mbi menaxhim e rezervave të armëve duke përdorur standardes ndërkombëtare për kontrollin e armëve të vogla	UNDP
57.	Sistemi i Menaxhimit të integritetit	EU
58.	Kursi I Riqertifikimit	PK
59.	Menaxhimi dhe kontrolli financiar	EU

9. PAISJET TEKNOLOGJIKE TË IPK-së- DHOMA E INTERVISTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës gjatë punës se vet ka në përdorim pajisje speciale për masa të fshehta të hetimit të rasteve si dhe hapësira të veçanta të cilat janë të domosdoshme për të garantuar kualitet dhe cilësi në realizimin e detyrave të saj.

Në kuadër të këtyre pajisjeve përfshihen: kamera të rezolucionit të lartë, pajisje për video dhe audio incizim të formateve të ndryshme, dylbi speciale etj.

Këto pajisje, shumica e tyre janë donacion nga partneri me i vlefshëm ICITAP-i Amerikan të cilët kanë ndihmuar IPK-në në të gjitha mënyrat dhe mundësitë e mundshme.

Inspektorati Policor i Kosovës gjithashtu ka në përdorim edhe dhomën e veçantë të intervistimit e cila është e pajisur me një sistem video dhe audio incizimit e cila i jep mundësin që dëshminë ta ruaj të plotë me të gjitha elementet përcjellëse.

Përmes këtyre pajisjeve IPK ka arritur të kryej shumë raste të ndërlikuara hetimore me një efikasitet dhe cilësi të shkëlqyer duke arritur të siguroj dëshmi ligjore falë edhe kreativitetit të hetuesve gjatë përdorimit të tyre.



Figure 5. Disa nga pasijet e IPK-së për masa të fshehta




Figure 6. Dhoma e intervistimit në IPK me system video-audio incizim (donacion nga OSBE-ja)

10. PRANIMI I ANKESAVE DHE HETIMI I RASTEVE GJATË VITIT 2015

Bazuar në kompetencat e dala nga ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, IPK-ja është e obliguar që të pranoj të gjitha ankesat e qytetarëve ndaj punonjësve të PK-së si dhe të shqyrtoj dhe përcaktoj se cilat nga ankesat hetohen nga IPK-ja dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve tjera përgjegjëse.

Sipas ligjit për IPK-në, çdo qytetar mund të ushtroj ankesë në IPK lidhur me supozimin e tyre se ndonjë nga pjesëtarët e PK-së ka kryer detyrat në kundërshtim me rregullat dhe procedurat në fuqi.

IPK gjatë vitit 2015 ka pranuar dhe ka menaxhuar 1237 ankesa dhe informata dhe në krahasim me vitin e kaluar, ku IPK ka trajtuar 1304 ankesa, këtë vit numri i ankesave është në rënie për 67 apo (5.4%).

Gjatë periudhës së raportimit, Policia e Kosovës ka pasur 8980 punonjës. Në total ishin 220 punonjës të PK-së si subjekt i hetimit nga IPK-ja. Të paraqitur në përqindje kjo i bie që vetëm 2.45% i punonjësve të PK-së ishin nën hetim apo 0.95% më pak se vitin e kaluar. Pra në vitin 2015 numri i punonjësve të hetuar është më i vogël për 85 punonjës se në vitin 2014.

Diagrami 1: Ankesat e pranuar, krahasim 2012-2015



Diagrami 2: Përqindja e punonjësve të PK-së të hetuar IPK



Diagrami 3: Krahasimi i punonjësve të PK-se të hetuar nga IPK-ja 2012-2015



Sipas “Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IPK” parashihet se Departamenti për Shqyrtimin dhe Menaxhimin e Ankesave (DSHMA) merret me ankesat e qytetarëve. Ky departament ka përgjegjësinë të garantojë se ankesat në adresë të punonjësve të PK-së trajtohen në mënyrën e duhur. DSHMA-ja ka detyrë dhe përgjegjësi të pranojë dhe mbledh ankesa, të përcaktoj natyrën e shkeljes dhe t'i dërgoj ato tek autoritetet përgjegjëse brenda dhe jashtë IPK-së.


Mundësitë të cilat ofron IPK-ja se si qytetarët mund të parashtrojnë ankesat e tyre janë:

- Përmes dorëzimit në formë fizike (dorëzimit fizik ose me postë),
- Përmes dorëzimit në formë elektronike,
- Përmes deklarimit me anë të telefonit (080003333),
- Përmes dhënies së deklaratës personale, direkt tek personeli i DSHMA-së,
- Përmes kutive të ankesave,
- Përmes dorëzimit me anë të palëve tjera¹.


Sipas statistikave nga 945 ankues kemi këto të dhëna: meshkuj ishin (840) **apo 88.9%** ndërsa femra njëqind e pesë (105) **apo 11.1%**. Ndërsa në bazë të nacionalitetit kemi këto të dhëna: shqiptarë ishin 856 **apo 90.6 %** ankues; serb 61 apo **6.5 %** ankues; boshnjak 16 apo **1.7 %**, ankues; turq 3 apo **0.3 %**, ankues, të tjerë 9 apo **0.9 %** ankues (gjerman, italian, jordanez etj).

Këto statistika tregojnë se IPK-ja gëzon besueshmërinë e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Diagrami 4: Ankuesit sipas gjinisë, krahasim 2013-2015




Diagrami 5: Ankuesit sipas etnisë, krahasim 2013-2015



Gjatë vitit 2015, IPK ka pranuar gjithsej njëmijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë (1536) shkresa. Nga këto shkresa janë pranuar njëmijë e dyqind e pesëmbëdhjetë (1215) ankesa, ndërsa njëzet e dy (22) të tjera kanë qenë informata.

¹ Pranimi i ankesave përmes palëve të tjera nënkupton pranimi përmes personit të autorizuar .

Diagrami 6: Pranimi i ankesave, krahasim 2013-2015



Në krahasim me vitin e kaluar, ankesat që janë parashtruar nga qytetarët përmes Policisë së Kosovës kanë shënuar rënie të dukshme prej 243 ankesa apo 50.8 %, iniciimet e brendshme nga vet Policia e Kosovës kanë shënuar rritje me 46 ankesa apo 17.6 %, ankesat në formë elektronike kanë shënuar rritje për 20 ankesa apo 17.2%, ankesat që pranohen nga institucionet tjera kanë shënuar rritje për 94 ankesa apo 341 %. Këtë vit ka ngritje edhe të numrit të informatave të ndryshme.

Këto statistika flasin për vetëdijesim të qytetarëve dhe institucioneve tjera të Kosovës lidhur me kompetencat e IPK-së, për profesionalizmin dhe llojllojshmërinë e mundësive që ofron IPK-ja për të parashtruar ankesë në njërën anë, kurse në anën tjetër kemi një përkushtim dhe profesionalizëm nga Policia e Kosovës të cilët po tregojnë se janë të përkushtuar që çdo shkelje që ndodh në radhët e tyre të përcillet sa më shpejt në IPK për hetim.

Sipas statistikave të IPK-së mbi pranimin e ankesave sipas muajve, muajt më të ngarkuar me ankesa gjatë vitit 2015 kanë qenë muajt gusht, dhjetor dhe tetor mesatarja e ankesave për muaj është 103 ankesa për muaj.

Diagrami nr.07: Trendi i pranimit të ankesave sipas muajve, 2015



Pas pranimit dhe shqyrtimit të ankesave ato procedohen tek autoritetet përgjegjëse për t'u hetuar. Varësisht nga hapat që ndërmerren për procedim të mëtejshëm të lëndës, IPK njofton parashtruesin e ankesës për statusin e ankesës së tij.

Nga (1237) njëmijë e dyqind e tridhjetë e shtatë ankesa dhe informata të pranuar: (556) Pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë ankesa apo 45 %, janë proceduar në Departamentin e Hetimeve në IPK për hetim


preliminar² dhe dy (2) raste të hetimit disiplinorë të profilit të lartë; (655) Gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë ankesa pas shqyrtimit janë dërguar në Drejtorinë e Hetimeve të Brendshme në Policinë e Kosovës për hetim disiplinor apo 53.0 %; (10) Dhjetë raste janë proceduar në Departamentin e Hetimeve Speciale (të IPK-së) për grumbullim të informatave apo 0.8 %; (1) Një rast është dërguar për trajtim në Departamentin e Inspektimeve apo 0.1 %, (7) Shtatë raste janë mbyllur në DSHMA apo 0.6 % dhe (6) Gjashtë raste janë dërguar në Komisionin e Ankesave dhe Parashtrësive në kuadër të PK-së apo 0.5 %.

Diagrami nr.08: Paraqitja tabelore e procedimit të ankesave nga DSHMA 2014-2015



Pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë (556) ankesa janë dërguar në Departamentin e Hetimeve për hetime preliminare. Gjatë hetimit preliminar të këtyre ankesave, njëqind e shtatëdhjetë e tre (173) ose 31.1 % ankesa kanë rezultuar me elemente të veprës penale dhe kanë marrë numër rasti për t'u hetuar tutje, ndërsa dyqind e tridhjetë e dy (232) ose 41.7 % raste kanë rezultuar me elemente të shkeljes disiplinore dhe janë kthyer në DSHMA për t'u përcjellë në Drejtorinë e Standardeve Profesionale në Policinë e Kosovës për hetime disiplinore, kurse Njëqind e dyzet e një (141) ose 25.4 % raste janë ende në hetim preliminar të cilat raste kryesisht janë pranuar në dy mujorin e fundit të vitit 2015 dhe 10 raste tjera apo 1.8 % janë raste të cilat janë proceduar në institucionet tjera përkatëse.


Diagrami nr.09: Paraqitja e rezultateve nga hetimi preliminar i DH-se për 556 rastet e pranuar nga DSHMA 2015



² Hetimi preliminar është veprimi hetimor të cilin e ndërmerr IPK-ja me qëllim të verifikimit dhe grumbullimit të informacioneve deri sa të krijohet bindja se ekziston dyshim i arsyeshëm për ekzistimin e elementeve të ndonjë vepre penale të kryer nda ndonjë punonjës i Policisë së Kosovës.

Nga 173 raste me elemente të veprës penale, 161 raste janë dërguar nga Departamentet e Hetimeve në prokuroritë kompetente kurse 12 ose 6,9 % raste janë në proces të hetimit³ të bartura për vitin 2016.


Diagrami nr.10: Rastet e dërguara në prokurori dhe rastet në proces në DH, krahasim 2015, 2014, 2013



Nga 161 janë dërguar në prokurori, 108 ose 67.1 % raste janë dërguar me kallëzim penal⁴ nga Departamentet e Hetimeve në prokuroritë kompetente. Ndërkaq me raport të veçantë⁵ janë dërguar 53 ose 32,9 % raste.


Inspektorati Policor i Kosovës ka arritur që 93.1% të rasteve me elemente kriminale ti hetoj dhe procedoj tutje në prokurori me kallëzim penal ose me raport të veçantë.

Diagram nr.11: Mënyra e dërgimit të rasteve në prokurori nga DH




Gjatë vitit 2015, prej 108 rasteve që janë dërguar në prokurorit kompetente është ngritur aktakuzë për 24 kallëzime penale dhe rastet janë proceduar në gjykatat kompetente (4 raste më pak se vitin e kaluar) kurse shtatë (7) kallëzime penale janë hedhur poshtë nga prokuroria në mungesë të fakteve.

Diagram nr.12: Statusi i rasteve të dërguara në prokurori nga DH




Vitin e kaluar kanë qenë 99 kallëzime penale të ngritura nga IPK-ja që ishin në proces në prokuroritë kompetente të Republikës së Kosovës ndërsa këtë vit janë 77 raste në proces.

Diagram nr.12: Statusi i rasteve të dërguara ne prokurori nga DH



Gjatë vitit 2015, IPK-ja ka ndërmarrë këto masa dhe rekomandime: 23 arrestime, 39 rekomandime për suspendime dhe 11 rekomandime për transfere.

Diagrami nr.13: Masat dhe rekomandimet nga IPK-ja, 2012, 2013, 2014, 2015



Në tabelën⁶ nr. 01 janë paraqitur masat disiplinore që janë ndërmarrë pas hetimit të ankesave të cilat kanë elemente të veprës penale dhe ankesat me elemente të shkeljeve disiplinore. Këto statistika janë prezantuar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në Policinë e Kosovës. Për rastet me elemente të veprave penale janë dhënë 30 masa disiplinore çka d.m.th se përveç se rasti është dërguar në Prokurori, punonjësve të policisë iu është shqiptuar edhe masë disiplinore, ndërsa për ankesat me elemente të shkeljeve disiplinore janë dhënë 577 masa disiplinore.

⁶ Në tabelën nr. 01 janë te paraqitura masat disiplinore nga ankesat qe janë shqyrtuar dhe janë dërguar për tu hetuar nga Departamentin e Hetimeve ne IPK për elemente te veprave penale. Pasi kane përfunduar hetimet rasti ka shkuar ne Prokurorin themelore një kopje iu është dërguar Drejtorisë se Standardeve Profesionale ne Policinë e Kosovës për tu hetuar edhe për shkelje disiplinore dhe nga DSP-ja hetimet kane rezultuar me masat e dhëna te cilat janë paraqitur ne tabelën e lartshënuar.

Tabela nr.01: Masat disiplinore të shqiptuara nga PK-ja gjatë vitit 2015

MASAT DISIPLINORE TË DHËNA NGA PK-JA			
	Te veprat penale	Te shkeljet disiplinore	gjithsej
Vërejtje me gojë	1	182	183
Vërejtje me shkrim	4	119	123
Ndalesë në pagesë prej 5% deri 20 % e pagës mujore bruto deri në 2 muaj.	0	245	258
Ndalesë në pagesë 21% deri 30 % e pagës mujore bruto nga 2 deri 6 muaj	13		
Degradim	0	1	1
Ulje në pozitë	0	0	0
Ndërprerje e marrëdhënies se punës	12	30	42
Gjithsej	30	577	607

Tabela më poshtë tregon për numrin e vendimeve nga gjykatat kompetente që në total për vitin 2015 janë marrë katër (4) vendime:

Tabela nr.02: Paraqitja tabelore e vendimeve të gjykatave gjatë vitit 2015

VENDIMET E GJYKATAVE						
Gjykata Themelore Prishtinë	Gjykata Themelore Mitrovicë	Gjykata Themelore Pejë	Gjykata Themelore Gjakovë	Gjykata Themelore Prizren	Gjykata Themelore Ferizaj	Gjykata Themelore Gjilan
1	3	0	0	0	0	0
Totali: 04						

Lloji i vendimeve që janë marrë nga gjykatat kompetente janë:

- Dënim me gjobë në vlerë prej 2000.00 euro
- Dënim prej pesë muajve burgim me kusht
- Dënim me gjobë në vlerë prej 300.00 euro
- Dënim me gjobë në vlerë prej 400.00 eurove.

Gjatë vitit 2015, IPK-ja ka hetuar raste të llojeve dhe natyrave të ndryshme. Pesë (5) rastet më të shpeshta që janë hetuar gjatë vitit 2015 ishin: 45 raste rrezikim i trafikut publik, 39 raste keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, 27 raste lëndim i lehtë trupor, 12 raste keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, 11 raste marrje e rryshfetit, 8 raste kanosje.


Diagram nr.14: Pesë rastet me të shpeshta të hetuara nga IPK



Gjatë katër viteve të kaluara (2012-2015) pothuajse të njëjta veprat prijnë në listën e pesë veprave më të shpeshta në kompetencë të IPK-së për t'u hetuar.


Pozitive shihet trendi i rënies së rasteve ku përfshihen veprat e përdorimit të forcës nga zyrtarët policorë siç janë lëndimi i lehtë trupor apo keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, për të cilën IPK konsideron se ka ardhur si rezultat i inspektimeve të shpeshta të ndërmarra nga IPK-ja si dhe të hetimeve cilësore në këtë fushë si dhe nga përkushtimi i menaxhmentit policor për të ofruar trajnime shtesë lidhur me këtë fushë të detyrave policore.

Diagrami nr.15: Pesë veprat më të shpeshta, krahasim 2012- 2015



Inspektorati Policor edhe gjatë këtij viti kujdes të veçantë i ka kushtuar edhe veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare. Këtë vit IPK-ja ka hetuar 62 vepra penale me elemente të korrupsionit dhe veprave tjera kundër detyrës zyrtare ndër të cilat më të shpeshtat kanë qenë: 39 vepra të keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, 4 vepra falsifikim i dokumentit zyrtar, 11 vepra të marrjes së ryshfetit, 1 vepër të ushtrimit të ndikimit, 2 vepra zbulim i fshehtësisë zyrtare, 1 vepër të dhënies së ryshfetit, 2 vepër të përvetësimit në detyrë, 2 vepra të mashtrimit dhe 0 vepër të konfliktit të interesit.


Diagram nr.16: Veprat penale me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare – krahasim 2014, 2015



11. GRADAT DHE NJËSITË STRUKTURORE E PUNONJËSVE TË PK-së TË HETUAR NGA IPK-ja

Policia e Kosovës gjatë vitit 2015 ka pasur një personel prej 8980 punonjësve. Siç dihet Policia e Kosovës ka një strukturë organizative me funksione dhe detyra të ndryshme dhe si e tillë është e ndarë në nënndarje të shumta me detyra dhe përgjegjësi të llojllojshme. Në kuadër të këtij raporti paraqitet krahasimi në mes të numrit total të punonjësve të PK-së dhe numrit të hetuarve nga IPK-ja për shkeljet penale të këtyre punonjësve të Policisë së Kosovës të cilat janë në mandatin e IPK-së.

Tabela nr.17: Numri i punonjësve të PK-së sipas strukturës organizative dhe numri i të hetuarve nga IPK-ja në tërë Policinë e Kosovës sipas gradave




Nga totali i punonjësve të PK-së prej 8980 punonjës, nga të cilët 7881 janë zyrtarë policorë me grada të ndryshme, ndërsa personel civil - pa kompetenca policore janë 1099.

Policia e Kosovës ka të graduar një personel prej 1574 oficerëve të cilët menaxhojnë të gjitha vijat e menaxhimit, nga vija e parë menaxhuese e deri te niveli i lartë drejtues ekzekutiv. Në PK janë 965 rreshterë, 361 togerë, 137 kapitenë, 51 majorë, 38 nënkolonelë dhe 14 kolonelë.

Gjatë vitit 2015, IPK-ja ka hetuar 43 zyrtar të graduar, prej tyre 2 kolonelë, 1 nënkolonelë, 2 major, 3 kapitenë, 9 togerë, 26 rreshterë, 159 zyrtarë policorë si dhe 18 punonjës nga stafi civil.

Gjate viteve (2012-2015) trendi i implikimit të punonjësve policorë në vepra të cilat hetohen nga IPK-ja është në rënie të numrit të policëve dhe rreshterëve, si grada të ulëta menaxheriale. Te të gjitha gradat në Policinë e Kosovës këtë vit është shënuar ulje e numrit të zyrtarëve që kanë qenë subjekt i hetimeve penale, përjashtimisht grada kolonel dhe major që kanë shënuar rritje, ku në vitin 2014 nuk kanë qenë subjekt hetimi asnjë zyrtarë me gradë kolonel, kurse këtë vit janë hetuar dy zyrtar me gradën e kolonelit. Gjithashtu në këtë vit janë hetuar dy (2) zyrtar me gradë major e që në vitin 2014 ka qenë vetëm një (1).


Diagrami nr.18: Gradat e punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK -2012-2015



Bazuar në strukturën e saj organizative, Policia e Kosovës përbëhet nga pesë departamente. Numrin më të madh të personelit e ka Departamenti për Operacione me 6165 punonjës apo 68.7% të tërë personelit të Policisë së Kosovës, Policia Kufitare me 1350 punonjës apo 15 %, Departamenti për Hetime me 584 apo 6.5%, dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore me 415 punonjës ose 4.6 % e personelit në Policinë e Kosovës dhe Departamenti për Shërbime Mbështetëse me 290 punonjës apo 3.3%.

Numri më i madh i të hetuarve nga IPK-ja janë punonjës të Departamentit për Operacione, ku nga 6165 punonjës që ka ky departament, subjekt i hetimeve në IPK kanë qenë gjithsej 150 punonjës. Departamenti për Kufi nga 1350 punonjës, të hetuar nga IPK ishin 43 punonjës. Departamenti për Hetime nga 584 punonjës, të hetuar nga IPK ishin 5 punonjës; Departamenti për Burime Njerëzore nga 415 punonjës, të hetuar nga IPK ishte 1 punonjës dhe Departamenti për Shërbime Mbështetëse nga 290 punonjës, të hetuar nga IPK ishin 21 punonjës.

Diagrami nr.19: Paraqitja shpërndarjes së punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas Departamenteve në Policinë e Kosovës 2014-2015




Duke qenë se Departamenti për Operacione ka numrin më të madh të punonjësve në PK si dhe me numrin më të madh të të hetuarve nga IPK-ja, në vazhdimësi të raportit është shtresuar sipas nënndarjeve tjera brenda këtij departamenti se në cilat njësi gjinden 150 punonjësit e hetuar nga IPK-ja në këtë departament.

Departamenti për Operacione ndahet në tre (3) divizione; Divizioni për Siguri Publike njëqind e tridhjetë e një (131) zyrtar të hetuar, Divizioni i Njësive të Specializuara trembëdhjetë (13) zyrtar të hetuar dhe Divizioni i Komunikacionit Rrugor gjashtë (6) zyrtar të hetuar nga IPK ja.


Nga të dhënat e paraqitura shihet se në të gjitha divizionet ka zbritje të numrit të zyrtarëve që kanë qenë subjekt i hetimit nga IPK ja, ulje me e theksuar është paraqitur në Divizionin për Siguri Publike nga numri 224 sa ka qenë në vitin 2014, këtë vit kemi 131 apo 41.5% më pak punonjës të hetuar.

Diagrami nr.20: Shpërndarjes së 150 punonjësve të hetuar nga IPK-ja në Departamentin për Operacione sipas nënndarjeve të saj në divizione



Në tabelën më poshtë paraqitet trendi i punonjësve që ishin subjekt i hetimeve nga IPK sipas Drejtorive Rajonale Policore për tre vite 2012- 2015.

Diagrami nr.21: Shpërndarjes së 150 punonjësve të hetuar nga IPK-ja nga Divizioni për Siguri Publike sipas Drejtorive Rajonale Policore




Gjatë vitit 2015, Divizionit për Siguri Publike ju është shtuar edhe Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovës ,ku pjesa e përgjegjësisë së këtij rajoni më parë ishte nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë.

Sa i përket numrit të punonjësve në Policinë e Kosovës në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kosovës ka ulje të numrit të hetuarve nga IPK-ja. Krahasuar nga viti paraprak DRP-Gjilan ka ulje më të theksuar ku në vitin 2014 ishin gjithsejtë 50 punonjës që ishin subjekt i hetimit në vitin 2015 janë vetë 11 punonjës, gjithashtu edhe DRP Prishtinë , DRP Ferizaj, DRP Mitrovicë Jug ka ulje të dukshme, ndërsa ulje më e vogël është paraqitur në DRP Prizren, DRP Pejë dhe DRP Mitrovicë Veri.

Në diagramin nr. 22 paraqitet numri i rasteve sipas Stacioneve Policore të cilat janë nën komandën e Drejtorive Rajonale Policore në kuadër të Divizionit për Siguri Publike-Departamentit për Operacione.


Stacioni Policor Prizren kryeson me numrin më të madh të punonjësve të hetuar nga IPK-ja me gjithsej dymbëdhjetë (12) punonjës ndaj të cilëve janë zhvilluar hetime penale, më pas vije Stacioni Policor Ferizaj me nëntë (9) punonjës, Stacioni Policor Veriu – Mitrovicë tetë (8) punonjës, kështu më radhë . Vlen të ceket se Stacionet Policore Skenderaj, S.P Kaçanik, S.P Partesh, S.P Klllokot, S.P Kamenicë, S.P Dragash, S.P Rahovec, S.P Junik, S.P Deçan, S.P Gjakovë, S.P Obiliq, dhe S.P Podujevë nuk kanë asnjë zyrtarë që ka qenë subjekt i hetimit penal nga IPK ja.

Diagrami nr.22: Punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas Stacioneve Policore




Në diagramin nr.23 shihet shpërndarja e 41 punonjësve të Policisë Kufitare të hetuar nga IPK-ja, sipas Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare. Drejtoria Rajonale të Policisë Kufitare Veri kryeson me njëzet e dy (22) zyrtar subjekt i hetimeve penale nga IPK ja, më pas vije DRPK Perëndimi me trembëdhjetë (13), DRPK Lindje me shtatë (7) dhe Stacioni Policor Aeroport me një (1) të hetuar.

Diagrami nr.23: Punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare



Në diagramin nr.24 paraqitet numri i punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK-ja, sipas Stacioneve Policore Kufitare të cilat janë nën komandën e Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare. Sipas të dhënave SPK Vërmicë ka numrin më të madh të zyrtarëve të hetuar nga IPK ja me tetë (8), më pas renditën SPK Merdar me shtatë (7) zyrtar ,SPK Dheu i Bardhë me pesë (5) e kështu më radhë, ndërsa SPK Muqibabë, SPK Gllloboçicë, SPK Qafa e Morinës, SPK Qafa e Prushit dhe SPK Bërnjak nuk kanë asnjë zyrtar subjekt hetimit nga IPK ja.

Diagrami nr.24: Punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas Stacioneve Policore Kufitare



12. INSPEKTIMET GJATË VITIT 2015



Figure 7. Inspektorët e IPK-së nga Departamenti i Inspektimit gjatë takimit përmbyllës të inspektimit me të inspektuarit, menaxhmentin e lartë të Policisë së Kosovës

Një ndër funksionet bazë të Inspektoratit Policor të Kosovës është edhe zhvillimi i inspektimeve ndaj Policisë së Kosovës. Përmes procesit të inspektimit, IPK-ja bënë vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave në Policinë e Kosovës, duke:

- Përcaktuar nëse ligjet, rregulloret përkatëse dhe parimet e procedurat e Policisë së Kosovës zbatohen ashtu si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saj;
- Përcaktuar nëse burimet e Policisë shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efikase si dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat organizative;
- Parandaluar shkeljet që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së Policisë së Kosovës;
- Identifikuar mangësitë dhe duke rekomanduar masa ligjore e organizative për funksionim më të mirë të Policisë së Kosovës.

Në përputhje me planin vjetor 2015 të Departamentit të Inspektimeve gjatë këtij viti kanë arrit rezultate shumë të mira në punën e tyre të cilat janë të dëshmuar me raporte profesionale me cilësi të lartë. IPK ka realizuar gjithsej tetë projekte inspektimi; pesë inspektime të rregullta dhe tre të jashtëzakonshme.

Procesi i inspektimit i një fushe policore përfshinë një mori veprimesh profesionale të cilat kalojnë nëpër faza të ndryshme, duke filluar nga faza e hulumtimit dhe identifikimit të fushës së caktuar për inspektim, përgatitja e planit të punës dhe përzgjedhja e metodologjisë së inspektimit për të kaluar në punën në terren për të mbledhur faktet dhe dëshmitë lidhur me gjendjen e fushës së caktuar nën inspektim e deri të analizimi dhe faktimi i të gjeturave për tu prezantuar në raportin përfundimtar të inspektimit.

Duhet cekur se në vitin 2015, Departamenti i Inspektimit gjatë realizimit të projekteve të inspektimit (pesë inspektime të rregullta dhe tre të jashtëzakonshme) ka mbajtur edhe takimet përmbyllëse me të inspektuarit, gjegjësisht Policinë e Kosovës, dhe në asnjë prej këtyre takimeve nuk ka pasur asnjë problem dhe gjithmonë ka pasur një pajtim të plotë me të gjeturat e prezantuara në raportet e inspektimit nga Inspektorët e IPK-së.

Inspektimet e realizuara gjate vitit 2015 ishin:

1. **Vlerësimi i performancës policore në menaxhimin e turmës gjatë protestave qytetare me 27.01.2015;**
2. **Menaxhimi i flotës së automjeteve dhe logjistikës;**
3. **Kushtet e punës në Policinë Kufitare Drejtoria Rajonale Lindja- Kaçanik;**
4. **Menaxhimi i patrullimeve në trafik dhe sigurisë në rrugë;**
5. **Inspektimi mbi zbulimin dhe hetimin e krimit si dhe administrimin e rasteve;**
6. **Vlerësimi i menaxhimit të punës në Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj;**
7. **Inspektimi i procesit të gradimit në Policinë e Kosovës;**
8. **Vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Policimin në Bashkësi (2012-2016).**

Gjatë zbatimit të inspektimeve të vitit 2015, Inspektorati Policor i Kosovës, nga gjithsej tetë inspektime;

- janë inspektuar 168 njësi policore;
- janë intervistuar rreth 275 punonjës policorë;
- janë kontrolluar 24289 dosje të ndryshme, dhe;
- një numër të konsiderueshëm i dokumenteve të ndryshme (ligje, udhëzime administrative, procedura standarde të operimit)
- ka inspektuar një numër të konsiderueshëm të automjeteve të Policisë së Kosovës.

Inspektorati Policor i Kosovës, në tetë inspektime të zhvilluara gjatë vitit 2015, ka hartuar raportet e inspektimit ku janë paraqitur të gjeturat dhe janë nxjerrë pesëdhjetekatër (54) rekomandime për Policinë e Kosovës.

Këto raporte me rekomandime fillimisht janë prezantuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës pastaj janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të Inspektoratit Policor të Kosovës për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Identifikimi i fushave policore për zhvillimin e inspektimeve është bazuar në rëndësinë e programeve/fushave policore dhe riskun e identifikuar në bazë të hulumtimeve të zhvilluara ku janë identifikuar fushat policore për t'u inspektuar të cilat janë përfshirë në planin vjetor të inspektimeve për vitin 2015.

Disa nga fushat inspektuara gjatë vitit 2015 janë identifikuar bazuar në të dhënat statistikore dhe informacionet që janë marrë nga Departamenti i Hetimeve, Departamenti i Hetimeve Speciale dhe Departamenti i Shqyrtimit dhe Menaxhimit të Ankesave në IPK.

Këto të dhëna statistikore dhe informacione pas analizimit nga Departamenti i Inspektimeve, kanë treguar edhe indikatorët e rrezikut për shkelje të mundshme ligjore dhe për keq-menaxhim nga Policia e Kosovës.

Nga këto të dhëna është konstatuar se ka nevojë për inspektimin e këtyre fushave për të identifikuar problemet dhe për të rekomanduar zgjidhje.

Nga këto statistika dhe informacione tjera janë përzgjedhur katër tema të inspektimit; “Menaxhimi i flotës së automjeteve dhe logjistikës”; “Kushtet e punës në Policinë Kufitare Drejtoria Rajonale Lindja- Kaçanik”; “Vlerësimi i menaxhimit të punës në Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj” dhe “Inspektimi i procesit të gradimit në Policinë e Kosovës”.

Projekti i inspektimit “Inspektimi mbi zbulimin dhe hetimin e krimit si dhe administrimin e rasteve” është zhvilluar si inspektim i rregullt për të vlerësuar nivelin e menaxhimit dhe performances se Policisë së Kosovës në këtë fushë të policimit, kurse projekti i inspektimit “Vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Policimin në Bashkësi (2012-2016)” ishte një inspektim panoramik për të parë dhe vlerësuar formën e organizimit dhe veprimit në zbatimin e strategjisë për policim në bashkësi si metodë e avancuar dhe moderne e policimit me karakter proaktiv.

Inspektimi “Vlerësimi i performancës policore në menaxhimin e turmës gjatë protestave qytetare me 27.01.2015” është realizuar si domosdoshmëri pas protestave qytetare me 27.01.2015 për të vlerësuar punën e Policisë së Kosovës gjatë menaxhimit të turmës në këtë protestë.

Sikurse edhe në vitet paraprake pas çdo inspektimi janë zhvilluar takimet përmbyllëse të organizuara pas secilës fushë së inspektuar.

Këto takime kanë kontribuar drejt fuqizimit të bashkëpunimit të mirëfilltë në mes Inspektoratit Policor të Kosovës dhe Policisë së Kosovës (PK-së), që pas përpilimit të draft raporteve nga çfarëdo fushë inspektuese të caktohen takime përmbyllëse në mes të këtyre dy organizatave.


Këto takime përmbyllëse janë realizuar me qëllim të diskutimit dhe argumentimit të të gjeturave që IPK i ka prezantuar në raportet e inspektimeve të zhvilluara.

Kontributi i pjesëmarrësve në takim ka qenë i jashtëzakonshëm, ku ka pasur pajtueshmëri me të gjeturat që janë prezantuar në raportet e inspektimit duke konsideruar se të gjitha të gjeturat janë të bazuara dhe prezantojnë realisht gjendjen e gjetur gjatë inspektimit të punëve policore për periudhën e caktuar.

Theks të veçantë PK-ja i ka vënë diskutimit, i cili ka rrjedhur në drejtim të rekomandimeve që kanë dalë nga raportet e inspektimeve si rezultat i të gjeturave.

Nga të gjitha fushat e inspektuara janë paraqitur gjithsej pesëdhjetë (54) rekomandime për të cilat të gjithë pjesëmarrësit janë pajtuar dhe kanë potencuar rëndësinë e tyre për secilën çështje të paraqitur në rekomandim.

Diagrami nr.25: Numri i projekteve te inspektimit dhe numri i rekomandimeve te dala, krahasim 2012-2015




13. SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme (DFSHP) në Inspektoratin Policor të Kosovës ka rol mbështetës dhe shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punëve dhe arritjen e objektivave të Inspektoratit Policor të Kosovës.

DFSHP përmes personelit të saj përkujdeset që të zbatoj rregullativën ligjore që ka të bëjë me zbatimin e procedurave të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e buxhetit, menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe menaxhimin e sistemeve të teknologjisë informative dhe shërbimeve logjistike. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L -001, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, IPK ka të aprovuar këtë ndarje buxhetore:


Diagrami nr.26: Ndarja buxhetore bazuar në Ligjin Nr. 05/L -001, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015



Mirëpo, gjatë procesit të rishikimit të buxhetit për vitin 2015, buxheti i IPK-së, ka pasur ndryshime në dy prej kategorive ekonomike: Paga dhe Mëditje si dhe Mallra dhe Shërbime.

Buxheti i IPK-së, bazuar në ligjin me Nr. 05/L-046 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001 për buxhetin e Republikës së Kosovës, është paraqitur në tabelën në vijim:

Diagrami nr.26: Ndarja buxhetore bazuar në Ligjin Nr. 05/L-046 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015




Plani i Zotim – Shpenzimeve është menaxhuar duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, Planin e Rrjedhës së Parasë, Planin e Prokurimit për vitin 2015, si dhe aktiviteteteve të tjera operacionale.

Në këtë drejtim mund të konstatohet se gjatë vitit fiskal 2015 kemi proceduar:

- 192 kërkesa për zotim të mjeteve buxhetore, në vlerë prej 397,866.36€ si dhe
- 289 ekzekutime të lëndëve financiare në vlerë prej 268,108.13€ (duke mos llogaritur shpenzimet e krijuara nga Kategoria Ekonomike e Pagave dhe Mëditjeve, ngase mënyra e procedimit të tyre dallon nga Kategoritë e tjera).


Në tabelën dhe grafikun e poshtëshënuar janë të dhënat e shumave të shpenzuara dhe realizimi në përqindje, nëpër secilën Kategori Ekonomike veç e veç, duke përfshirë edhe Kategorinë Ekonomike të Pagave dhe Mëditjeve:

Diagrami nr.27: Të dhënat e shumave të shpenzuara dhe realizimi në përqindje, nëpër secilën Kategori Ekonomike për vitin 2015



Në tabelën dhe grafikun e radhës do të prezantohen të dhënat përfundimtare të gjeneruar nga sistemi SIMFK për vitin fiskal 2015:

Diagrami nr.28: Paraqitja e buxhetit, alokimit, shpenzimit dhe mbetjet buxhetore 2015



Divizioni i Burimeve Njerëzore menaxhon me nevojat e burimeve njerëzore për tërë punonjësit e IPK-së të cilët sipas strukturës kualifikuese, etnike dhe gjinore kanë këtë përbërje si në tabelën e më poshtme.

Tabela nr.3: Paraqitja tabelore sipas strukturës kualifikuese, etnike dhe gjinore në IPK

Struktura Kualifikuese		Struktura Etnike			Struktura gjinore		Totali i te punësuarve
I Larte	Mesëm	Shqiptar	Serb	Boshnjak	M	F	
66	7	68	3	2	55	18	73
90.4	9.6	93.15	4.12	2.73	75.34	24.66	100 %

Sipas të dhënave të prezantuara nga Divizioni i Burimeve Njerëzore, nga punonjësit e IPK-së janë ndjekur 10 trajnime, me qëllim të ngritjes profesionale të punonjësve operativ dhe administrativ.

Nga tabela nr. 4 shihet llojllojshmëria e trajnimeve të cilat kanë qenë shumë përmbajtjesore dhe specifike për punën, detyrat dhe përgjegjësitë që kanë punonjësit operativ dhe administrativ të IPK-së, për të arritur rezultate sa më efektive në zbatimin e mandateve të tyre ligjore.

Tabela nr.4: Trajnimet e punonjësve të IPK gjatë vitit 2015

Nr	Llojin e trajnimit	Emri i organizatës	Numrin e pjesëmarrësve
1	Trajnimi i përgjithshëm për hetimin e krimit të organizuar	European ofic	2
2	Hetimi bazik financiar	MPB	1
3	Punëtori për Mentorim dhe Internship	OSCE	1
4	Legal Aspects of Combating Corruption	ICITAP	1
5	Aspekte Ligjore te luftimit të korrupsionit	European ofic	7
6	Trajnimi i Hetimit të Narkotikëve	ICITAP	2
7	Trajnim, mbi menaxhim e rezervave të armëve duke përdorur standarde ndërkombëtare për kontrollin e armëve të vogla	UNDP	1
8	Sistemi i Menaxhimit të integritetit	EU	4
9	Kursi I Ricertifikimit	PK	48
10	Menaxhimi dhe kontrolli financiar	EU	2
	TOTALI		69

14. PROJEKTI PËR REGJONALIZIMIN E IPK-SË



Figure 8 . Zbulimi i pllakatës së IPK-së gjatë hapjes së zyrës regjionale në Gjilan

Projekti për regionalizimin e IPK-së në radhë të parë shihet si mundësi e mirë e ngritjes së nivelit të bashkëpunimit me qytetarë, si mjet preventiv drejt reduktimit të shkeljeve penale ose disiplinore dhe ngritjes së nivelit të integritetit të punonjësve të PK-së, shkurtimit të kohës së reagimit në rastet e veçanta dhe në situata kur kërkojnë veprime urgjente nga IPK-ja, etj.

Bazuar në këtë projekt, IPK gjatë vitit 2015 e sidomos në gjashtë mujorin e dytë të vitit ka pasur shumë aktivitete që kanë përfshirë takimet me zyrtarët e ARC-së, zyrës administrative në Mitrovicën e Veriut, zyrave rajonale të ARC-së, takime brenda IPK-së etj.

Si rezultat i angazhimeve është arritur që me sukses të realizohet faza e parë e projektit për hapjen e zyrave të IPK-së. Zyra e parë rajonale u hap më 18 shtator në Gjilan në zyrën e ARC-së afër objektit të gjykatës. Zyra e dytë rajonale e IPK-së në Prizren filloi punën më 09 tetor 2015 dhe e njëjta gjendet në objektin e Agjencisë së Regjistrimit Civil në Prizren afër objektit të Administratës Tatimore në Prizren në rrugën “Kukësi”.

Në ceremonitë e organizuara nga IPK-ja për hapjen e zyrave në Gjilan dhe në Prizren, të pranishëm ishin përfaqësues të Prokurorisë, Avokatit të Popullit, Agjencisë së Regjistrimit Civil, Policisë së Kosovës, përfaqësues të Komunave, si dhe përfaqësues të ICITAP-it amerikan dhe EULEX-it.

Sfiduese ishte gjetja e hapësirës për hapjen e zyrës së tretë të IPK-së në Mitrovicën e Veriut. Kryeshefi Ekzekutiv së bashku me Zëvendës Ministrin e MPB-së z. Milan Radojeviq të cilët pas disa takimeve të përbashkëta edhe me autoritetet lokale arritën të gjejnë hapësirat për hapjen e zyrës së IPK-së në Mitrovicën e Veriut.

Si rezultat i këtij takimi IPK hapi zyrën e saj edhe në Mitrovicën e Veriut e cila filloi punën më 30 dhjetor 2015. Kjo zyre e IPK-së ndodhet në rrugën “Mbreti Petër” (në anën e majtë të rrugës, në ndërtesën ku ndodhet Raiffaisen Bank, në katin e dytë).

15. BASHKËPUNIMI ME QYTETARË



Figure 9. Pamje nga takimi i zyrtarëve të IPK-së, Policisë së Kosovës dhe ICITAP-it me KKSb-në në Gjakovë

Në fushën e bashkëpunimit me qytetarët, IPK ka planifikuar koordinimin e fillimit të aktiviteteve për prezantimin e fushë-veprimtarisë së IPK-së para qytetarëve të Kosovës, në komuna të ndryshme në kuadër të forumeve të sigurisë si; Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSb-të), Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP) dhe Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSb).

Për organizimin e këtyre takimeve, IPK në bashkëpunim me ICITAP-in ka zhvilluar disa takime paraprake me zyrtarë nga MPB – Departamenti për Siguri Publike -Divizioni për Siguri në Bashkësi, PK- Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë, për të prezantuar dhe koordinuar këtë aktivitet.

Pas kësaj janë bërë përgatitjet e duhura dhe fillimisht është paraparë zhvillimi i aktiviteteve në tri komuna; Gjakovë, Vushtrri dhe Gjilan.

Me aktivitete të tilla është filluar së pari në Komunën e Gjakovës, aktivitet ky i cili ishte realizuar më 26.03.2015, për të vazhduar pastaj edhe në komunat tjera si në Komunën e Vushtrrisë më 17.04.2015 ku është zhvilluar aktiviteti me EVSB-së dhe në Komunën e Gjilanit më 28.04.2015.

Ky aktivitet është në vazhdimësi dhe do të zhvillohet edhe në Komunat tjera në Kosovë.

IPK edhe pse nuk është një nga institucionet në vijë të parë të frontit sa i përket sundimit të ligjit, që do t'ua mundësonte qytetarëve të formojnë perceptimet dhe mendimet e tyre nga përvojat direkte personale, në një sondazh të realizuar nga një OJQ, IPK është renditur si institucioni i tretë më i besueshëm i sigurisë në Kosovë pas Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së) dhe Policisë së Kosovës duke arritur 40 % të besueshmërisë së plotë dhe 27 % të besueshmërisë pjesëshe ("deri diku"). Prandaj, duke pasur parasysh se kjo është hera e parë që perceptimet e qytetarëve janë marrë lidhur me IPK nuk mund të tërhiqen analiza krahasuese, mund të arrihet në përfundim se perceptimi publik mbi IPK-në është pozitiv.

16. AMERIKA ME KOSOVËN



Figure 10. Aktivitete të IPK-së nga organizimi i Ambasadës Amerikane “Amerika me Kosovën”

IPK ishte pjesëmarrëse në aktivitetet e organizuara nga Ambasada Amerikane në Kosovë me temën “Amerika me Kosovën”.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që nxënësit të njoftohen më për së afërmi lidhur me mbështetjen që Ambasada Amerikane ofron për ta si dhe njohuri të përgjithshme lidhur me fushë-veprimtarinë e Institucioneve pjesëmarrëse në aktivitet.

Të pranishëm në këto aktivitete përveç përfaqësuesve nga Ambasada Amerikane dhe ICITAP, ishin edhe përfaqësues të MPB-së Drejtoria për Siguri Publike, Policia e Kosovës, Drejtoria për Arsim e Komunës gjegjëse dhe organizata tjera pjesëmarrëse.

Inspektorati Policor i Kosovës, gjatë këtij aktiviteti ka paraqitur para nxënësve materiale informative lidhur me veprimtarinë e IPK-së, si; revista, broshura informative, kartëvizita të cilat kanë përmbajtur numrin pa pagesë për thirrje në IPK, materiale këto të cilat ishin të dedikuara për nxënësit.

Po ashtu përveç që nxënësit kanë marrë materiale për veprimtarinë e IPK-së, ata po ashtu kanë parashtruar pyetje të ndryshme për zyrtarët e IPK-së, për çështje që kishin të bëjnë me fushë-veprimtarinë e IPK-së, ku të njëjtit kanë marrë përgjigje nga zyrtarët përfaqësues të IPK-së.

17. BASHKPUNIMI ME MEDIA



Figure 11 Pamje nga video spoti televiziv për promovimin e fushatës “Linja e kaltër”

Varësisht sipas nevojave operative në teren, në bashkëpunim me departamente të ndryshme në kuadër të IPK-së janë publikuar komunikata për media, janë organizuar takime ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK-ja. Aktivitetet e deritashme që janë realizuar gjatë vitit 2015 nga IPK në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë janë:

- publikimi i rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për media);
- dhënia e deklaratave për mediet, pjesëmarrja në debate televizive, emisione të karakterit informativ etj;
- publikimi i revistës “Integriteti”;
- Përgjigjja në kërkesat e adresuara nga mediet e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së etj.

Inspektorati Policor i Kosovës në vazhdimësi i ka njoftuar mediet për punën dhe aktivitetet që janë zhvilluar përmes formave të ndryshme me qëllim që të tregoj transparencë dhe informim të duhur qytetarëve dhe atë kryesisht duke trajtuar edhe kërkesat nga mediat e ndryshme.

Rol me rëndësi në njoftimin e publikut me punën e IPK-së ka luajtur edhe faqja zyrtare elektronike e cila është ri-dizajnuar në fillim të vitit 2015 duke inkorporuar ndryshimet e nevojshme drejt funksionalizimit të uebit të ri.

Përveç ueb faqes së IPK-së, një rol të rëndësishëm për informimin e qytetarëve ka pasur edhe përdorimi i rrjeteve sociale si Facebook dhe Twitter. Nga statistikat zyrtare të adresës zyrtare në Facebook vërehet ngritje e numrit të vizitorëve në adresën zyrtare të IPK-së.

Grupmosha që më së shpeshti viziton adresën zyrtare të IPK-së është mosha nga 25-34 vjet me 46% e përcjellë me grupmoshën 18-24 vjet që arrin në 24%. Në rritjen e numrit të vizitorëve në këtë rrjet social ka ndikuar azhurnimi me kohë dhe publikimi i foto lajmeve si dhe aktiviteve të ndryshme të IPK-së duke rritur numrin e pëlqimeve në mbi 3000 klikimeve.

18. Dizajnimi dhe organizimi i fushatës për “LINJËN E KALTËR”

Lidhur me këtë projekt është realizuar fushata vetdijësuese për numrin pa pagesë në bashkëpunim me zyrën për informim të EULEX dhe KFOR-it në përkrahjen e realizimit të video dhe audio incizimeve për IPK-në.

Në vitin 2015 janë realizuar tri video spote dhe tri audio- spote (në gjuhën shqipe dhe atë serbe) për IPK-në dhe janë transmetuar në Televizionet nacionale dhe ato lokale si dhe radiostacionet e ndryshme në Kosovë duke përfshirë edhe ato në veri të vendit.

Projekti “Linja e kaltër”(linja pa pagesë për qytetarët 080003333) është një ndër projektet që kërkon angazhim në vazhdimësi edhe gjatë vitit 2015 , pasi janë vendosur posterët në nivel të secilit stacion policor me informacione për “Linjën e kaltër” si dhe është bërë shpërndarja e broshurave për këtë projekt në aktivitete si; Amerika me Kosovën dhe zhvillimi i aktiviteteve me EVSB-të nëpër Komunat e Kosovës etj.



19. Revista “INTEGRITETI”

Një ndër aktivitetet e IPK-së për vitin 2015 në kuadër të angazhimeve për fuqizimin e transparencës ishte vazhdimi i publikimit të revistës së IPK-së “Integriteti”.

Përveç informimit të brendshëm dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në revistën zyrtare të IPK-së, revista “Integriteti” konsiderohet si një projekt i rëndësishëm për informimin e jashtëm e sidomos qytetarët e vendit dhe zyrtarët e Policisë së Kosovës por edhe partnerëve vendorë e ndërkombëtarë për angazhimet e IPK-së.

Numri i publikuar i revistës “Integriteti” përfshinë tema lidhur me aktivitetet e IPK-së si: “Këndi i Kryeshefit”, shkrime për “Linjën e kaltër”, zbatimin i rekomandimeve të inspektimeve, hapjen e zyrave rajonale, aktivitete në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar atë të marrëdhënieve me publikun etj.



20. Bashkëpunimi me Institucionin e Avokatit të Popullit

Inspektorati Policor i Kosovës dhe Avokati i Popullit si dy institucione të pavarura, kanë një bashkëpunim të ngushtë në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës. Ky bashkëpunim është jetësuar me komunikim të drejtpërdrejtë dhe në forma të tjera gjatë zbatimit të mandatit të dy institucioneve. IPK ka dhënë informata kthyesë për rastet për të cilat Avokati i Popullit ka shprehur interesim.



21. Bashkëpunimi me KMDLNJ-në (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut)

Inspektorati Policor i Kosovës dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut kanë një bashkëpunim të ngushtë në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës. Ky bashkëpunim i mirë ka reflektuar në komunikim të drejtpërdrejtë, shkëmbim të të dhënave dhe në forma të tjera gjatë zbatimit të mandatit të IPK-së.



22. Bashkëpunimi me Komisionin Parlamentar për Siguri, Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore Inspektorati Policor i Kosovës ka pasur një bashkëpunim të mirë edhe me Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës të Kuvendit të Republikës së Kosovës ku IPK çdo herë i është përgjigjur thirrjes për të raportuar lidhur me punën e IPK-së. IPK mirëpret përkrahjen e këtij Komisioni të Kuvendit të Republikës së Kosovës në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike.

23. Bashkëpunimi me Prokurorinë

Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore dhe menaxhmenti i saj kanë krijuar lidhje shumë të ngushta bashkëpunimi në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe veprave tjera penale në polici. Caktimi i Prokurorëve për të punuar me zyrtarët e IPK-së ka ndihmuar në trajtimin me profesionalizëm të rasteve të Inspektoratit.



Kjo ka ndikuar që Inspektorati Policor i Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit të Republikës së Kosovës të krijojnë raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në luftën e dukurive negative të cilat hasen në radhët e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, e në veçanti në luftimin e korrupsionit përmes, shkëmbimit të informacioneve lidhur me dyshimin e implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policor, bashkëpunimin në hetimin e rasteve që rezultojnë me veprime kriminale, dhënien e autorizimeve nga Prokuroria për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara hetimore nga ana e IPK-së, ndihmë dhe asistencë gjatë procesit të hetimor si dhe ofrimin e këshillave të ndërsjella në zgjidhjen e problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me luftimin e dukurive negative në Policinë e Kosovës.

24. Bashkëpunimi me Policinë

Bashkëpunim me Policinë e Kosovës është orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse, të paraparë edhe me legjislacionin në fuqi. Këtij bashkëpunimi i kanë prirë shumë takime që janë zhvilluar për të diskutuar çështje që ndërliken me fushëveprimin e Inspektoratit Policor.



Përveç takimeve të rregullta, IPK ka pasur edhe disa takime të tjera me zyrtarët e PK-së për marrëdhënie me publikun. Këto takime janë realizuar në frymën e bashkëpunimit dhe komunikimit strategjik kryesisht para publikimeve të raporteve të inspektimit duke diskutuar vijat e përbashkëta të komunikimit me media duke ju referuar të gjeturave nga fushat e inspektuara. IPK çmon bashkëpunimin e rregullt me Policinë e Kosovës që shpesh është në baza ditore duke shkëmbyer informata dhe duke përkrahur njeri tjetrin në luftimin e dukurive negative brenda Policisë së Kosovës.

Në shumë raste janë zhvilluar hetime e operacione të përbashkëta të cilat kanë rezultuar me një koordinim shumë të mirë në zgjedhjen e rasteve dhe zbatimin e mandateve ligjore të këtyre dy institucioneve. Në kuadër të bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, duhet të theksohet edhe qasja proaktive që ka PK-ja në raport me iniciimin e rasteve dhe ndërmarrjes së veprimeve konkrete për të ngritur nivelin e disiplinës në organizatë dhe ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit.

Në total gjatë vitit 2015 ishin 262 ankesa të trajtuara në IPK që janë iniciuar nga vet Policia e Kosovës ndaj zyrtarëve të saj. Ky numër i iniciimeve që në krahasim me vitet e kaluar është në rritje, kjo flet për angazhimin e shtuar të Policisë në drejtim të ngritjes së cilësisë së kontrollit të brendshëm dhe përmirësimit të performancës së PK-së.

25. BASHKPUNIMI I IPK-SË ME SHÇBA-NË NGA SHQIPËRIA



Figure 12 Pamje nga takimi nderqeveritar Shqiperi-Kosovë në Pallatin e Kongreseve në Tiranë ku u nënshkruan 12 marrëveshje bashkëpunimi.

Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë nënshkruar 12 marrëveshje bashkëpunimi në mbledhjen e përbashkët të mbajtur në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Marrëveshjet e nënshkruara nga Kryeministrat e dy vendeve kanë të bëjnë me fushën e sigurisë, tregtisë, bujqësisë, arsimit dhe kulturës.

Në mesin e 12 marrëveshjeve është edhe memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës në Kosovës mbi Forcimin e Bashkëpunimit në Fushën e Kontrollit të Brendshëm.

Ky memorandum ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e shërbimeve të kontrollit të brendshëm në të dy vendet, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të luftës kundër korrupsionit në radhët e policisë si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Marrëveshja mundëson sigurimin e një platforme për shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës në lidhje me çështjet e mbikëqyrjes policore dhe anti-korrupsion, nëpërmjet takimesh në nivel ekspertësh. Marrëveshja mundëson që Inspektorati Policor i Kosovës dhe Shërbimi për Çështje të Brendshme dhe Ankesa, të kenë një bashkëpunim të drejtpërdrejtë dhe mbështetje reciproke, në fushën e asistencës teknike dhe ndërtimit të kapaciteteve si instrumente kryesore të luftës kundër korrupsionit.

Marrëveshja parasheh edhe veprime operationale të përbashkëta, për zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë anti-ligjore të kryer nga punonjës policie të dy vendeve si Kosovës ashtu edhe Shqipërisë.

IPK ishte si pikë kontakti në mes MPJ të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë duke shkëmbyer me dhjetëra emaila që përfshinin diskutimet lidhur me përmbajtjen e marrëveshjes. IPK ka përgatitur edhe tri draft marrëveshje të karakterit të sigurisë me vendet e rajonit, respektivisht Kroacisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë në fushën e kontrollit të brendshëm, me kërkesën që procedurat për to të iniciohen dhe të negociohet për nënshkrimin e tyre me shtetet e rajonit.

26. KONFERENCA E 15-të e EPAC-ut (European Partners Against Corruption – Partnerët Evropian Kundër Korrupsionit)



Figure 13 Pamje nga Konferenca e 15 e EPAC-ut në Paris

IPK edhe këtë vit mori pjesë në Konferencën e 15-të me radhë të EPAC-ut (European Partners Against Corruption – Partnerët Evropian Kundër Korrupsionit) që u mbajt në Paris - Francë më 17-19 nëntor 2016.

Gjatë sesioneve plenare në këtë konferencë u trajtuan tema të rëndësishme si: zhvillimet e fundit lidhur me korrupsionin dhe luftimi i tij në shërbimet policore, sfidat në hetimin e rasteve ku përfshihen zyrtarët e lartë – praktikrat më të mira, mekanizmat e ri dhe të vjetër të mbikëqyrjes, inspektimet, trajnimet antikorrupsion, etj.

Prezantimet nga delegatët ngritën disa çështje të rëndësishme dhe që ndërlidhen me agjencitë e mbikëqyrjes policore.

IPK vlerësoi lartë rëndësinë e shkëmbimit të përvojave në mes institucioneve të mbikëqyrjes policore të shteteve evropiane.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj konference të EPAC-ut, IPK mori të drejtën e qasjes në EPE (European Platform for Experts) si platformë e EUROPOL-it.

Nga kjo konferencë doli edhe Deklarata e Parisit ku dolën disa thirrje për bashkëpunim dhe veprim në mes shteteve evropiane në fushën e luftimit të korrupsionit dhe mbikëqyrjes policore.

KONFERENCA PROFESIONAL VJETORE E 15 DHE KUVENDI TË PËRGJITHSHME
I PARTNERËVE EVROPIANË KUNDËR KORRUPSIONIT (EPAC / EACN)

FRANCE, 18-20 nëntor 2015

DEKLARATA E PARISIT 2015

Ne, krerët dhe përfaqësuesit kryesorë të organeve kombëtare të mbikëqyrjes policore dhe Autoritetet e anti-korrupsionit të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian,

Duke shprehur solidaritetin tonë me popullin francez dhe autoritetet lidhur sulmet e fundit terroriste, si dhe mirënjohjen dhe admirimin për Inspektoratin e Përgjithshëm të Policisë Kombëtare (IGPN), për bujarin dhe mikpritjen dhe organizimin efikas të kësaj konference në këtë periudhë të vështirë kohore;

Duke kujtuar konventat ndërkombëtare, instrumentat dhe mekanizmat, në veçanti Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), konventat përkatëse të Këshillit të Evropës, mekanizmat e monitorimit të GRECO-s dhe Konventës Anti-Mitmarrjes të OECD;

Duke kujtuar Deklaratat e EPAC / EACN të miratuara në Sofje 2014, Krakov 2013, Barcelona 2012, Laksenburg 2011, Oradea 2010, Nova Gorica 2009, Manchester 2008, Helsinki 2007, Budapest 2006, Lisbonë 2005 dhe Vjenë 2004, dhe duke falënderuar Akademën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit (IACA) për organizimin e Sekretariatit;

Duke përshëndetur vendimin për të nisur një cikël të dytë të mekanizmit të rishikimit zbatimit të bëra gjatë seancës 6-të të Konferencës së Shteteve Palë të UNCAC mbajtur në Shën Petersburg, në nëntor 2015, dhe duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së shoqërisë civile;

Duke përsëritur nevojën për të ndjekur një qasje holistike dhe gjithëpërfshirëse në luftën kundër korrupsionit në bazë të kornizave gjithëpërfshirëse parandaluese dhe bashkëpunimit efikas ndërkombëtar ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit;

Duke pranuar se korrupsioni është një kërcënim serioz për zhvillimin dhe stabilitetin e cila ka pasoja të dëmshme në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe minon besimin publik në demokracinë dhe institucionet e saj;

Duke theksuar nevojën e domosdoshme për anëtarët tanë të jetojnë deri në pritjet e publikut të forta për të siguruar mjetet juridike efektive kundër korrupsionit;

Duke marrë parasysh konkluzionet e seminareve e konferencave dhe seancave plenare, duke theksuar nevojën

- për të përforcuar kulturën e etikës dhe transparencës, në veçanti përmes trajnimit dhe
- për të siguruar integritetin e policisë dhe për të forcuar objektive, demokratike dhe efektive mbikëqyrjen e shërbimeve të policisë për të përforcuar besimin e publikut në institucionet;

Bazuar në punën dhe rezultatet e dy grupeve punuese të EPAC / EACN të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në Sofje në nëntor 2014 për të zhvilluar rekomandime politike për Raportin e BE-së kundër korrupsionit, dhe për të përgatitur një mjet të dedikuar komunikimi EPAC / EACN brenda Platformës të Europolit për Ekspertë (EPE) bën këto thirrje:

- Thirrje për dënimin parandalues e krimeve të korrupsionit, përmes të dy dënimeve; me burgim dhe me mjete financiare dhe përmes sistemeve efektive të ripërtirjes së aseteve;
- Thirrje për futjen e një shkëmbimi ndërkufitar automatik të informacionit financiar për hetimin e krimeve të korrupsionit nga agjencitë e zbatimit të ligjit;
- Thirrje për krijimin e një mjeti të përshtatshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e dëshmitarëve kryesor të kërcënuar dhe mbylljen e krimeve të korrupsionit;
- Thirrje për të intensifikuar më tej bashkëpunimin dhe ndarjen në mes të autoriteteve të anti-korrupsionit dhe organeve të mbikëqyrjes policore në Evropë nëpërmjet mjet të sapo nisur komunikimit EPAC / EACN brenda EPE informacionit;

Deklarata do të qarkulluar gjerësisht nga anëtarët në vendet e tyre përkatëse dhe të dorëzohen në institucionet relevante të BE-së dhe organeve, Këshilli i GRECO-s dhe UNODC Evropës.



Figure 14. Pamje nga aktivitetet në Kongresin LOW TECH EUROPE në Bruksel ku pjesmarrës ishte edhe IPK

Fundi i tetorit shënoi edhe mbajtjen e kongresit Law Tech Europe Congress 2015 në Belgjikë, ku pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues nga Inspektorati Policor i Kosovës.

Nga pjesëmarrësit ky kongres u vlerësua lartë si për mundësinë e njoftimit lidhur me zhvillimet e fundit në teknologjinë informative dhe bazën ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Në këtë kongres IPK u njoftua me të arriturat e fundit të teknologjisë informative si në aspektin teknik po ashtu edhe atë legjislativ, ku u paraqitën prezantime të shumta të produkteve të teknologjisë informative të cilat ndihmojnë në sigurimin e dëshmive elektronike përmes proceseve hetimore, si dhe aspekti ligjor për përdorimin e këtyre teknologjive për të garantuar se nuk shkelen të drejtat dhe liritë e njeriut.

Në këto prezantime si prezantues ishin ekspert të firmave të njohura të teknologjisë informative si dhe prokurorë dhe gjyqtarë nga vende të ndryshme evropiane.

28. SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN E POLICISË



Figure 15 Pamje nga seminari "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Perspektivat e Planifikimit të Integritetit"

Në kuadër të angazhimeve të fuqizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, IPK ka organizuar dy seminare, njëri nga ta i karakterit ndërkombëtar.

Kjo u arrit në bashkëpunim me DCAF (Qendrën e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura), ku më 08.12.2015 u mbajt "Seminari ndërkombëtar për mbikëqyrjen dhe kontrollin e Policisë".

Ky Seminar ndërkombëtar u mbajt në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtri dhe solli së bashku përfaqësues të institucioneve për kontrollin dhe mbikëqyrjen policore nga shtete të ndryshme për të diskutuar praktikat aktuale dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes policore.

Pjesëmarrës në këtë seminar, përveç zyrtarëve nga Inspektorati Policor i Kosovës, Policia e Kosovës, dhe AKSP-ja, ishin edhe përfaqësues të institucioneve për mbikëqyrjen policore nga Franca, Hungaria, Irlanda, Norvegjia, Shqipëria, Holanda etj.

Pjesëmarrësit e këtij seminari gjatë adresimit me një fjalë rasti gjatë hapjes së seminarit ndërkombëtar i përshëndeti edhe ambasadorja e Zvicrës në Kosovë znj. Krystyna Marty-Lang.

Qëllimi i seminarit ndërkombëtar ishte shkëmbimi i praktikave dhe përvojave më të mira mbi kontrollin dhe mbikëqyrjen e policisë në mes përfaqësuesve të agjencive respektive nga shtetet pjesëmarrëse.

Gjatë seminarit u krahasuan edhe procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me përzgjedhjen, promovimin dhe trajnimin e personelit që janë përgjegjës për kontrollin dhe mbikëqyrjen e policisë.

Gjatë seminarit, pjesëmarrësit diskutuan së bashku me ekspertët ndërkombëtar edhe për atë se si vlerësimet psikologjike të sjelljeve të rrezikshme mund të përdoren për të sinjalizuar dhe parandaluar cenueshmërinë e shkeljes së integritetit.

Në fund të seminarit u shqyrtuan edhe mundësitë e bashkëpunimit në mes të organizatave të mbikëqyrjes policore në të ardhmen në fushën e trajnimeve por edhe fushat e tjera me fokus të veçantë në kompetencat e kontrollit dhe mbikëqyrjes policore.

Më 10.12.2015 u mbajt seminari me temën "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Perspektivat e Planifikimit të Integritetit", iniciuar nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), Qendra e Gjenezës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me akterët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në këtë tryezë morën pjesë Ministri i Punëve të Brendshme, Ambasadorja e Zvicrës në Kosovë, znj. Krystyna Marty Lang, përfaqësues nga IPK-ja, përfaqësues nga PK-ja, anëtarët e Komisionit Parlamentar për Siguri, përfaqësues të shoqërisë civile dhe njohës të çështjeve të Sigurisë etj.

Në këtë seminar u diskutua për kontrollin demokratik, përkatësisht mbikëqyrjen e institucioneve të rendit dhe ligjit, që nga pjesëmarrësit u cilësua si krciale dhe vendimtare për mirëmbajtjen dhe performancën e këtyre institucioneve.

Kjo tryezë pritet të ketë ndikim në ndihmesën që të bëhen planifikimet për integritetin policor dhe kjo nënkupton krijimin e një kornize vendimmarrëse.

Në këtë tryezë folën edhe përfaqësues të DCAF-it, Inspektoratit Policor të Kosovës, deputetë të Kuvendit të Kosovës, zyrtarë institucional dhe përfaqësues të shoqërisë civile.



Figure 16 Pamje nga seminari nderkombtare për mbikëqyrjen dhe kontrollin e policisë

29. PROJEKTI I BINJAKËZIMIT “FUQIZIMI I KAPACITETEVE PËR HETIME PENALE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPCIONIT”



Figure 17. Pamje nga vizita studimore e ekipit Kosovar përfshirë IPK-në në agjencione të zbatimit të ligjit në Hungari

Shumë aktivitete u realizuan gjatë vitit 2015 edhe në kuadër të projektit të binjakëzimit “Fuqizimi i kapaciteteve për hetime penale kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit” ku si partner përfitues janë Inspektorati Policor i Kosovës, Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit.

Në kuadër të komponentit të 4-të (Fuqizimi i mekanizmit të brendshëm mbikëqyrës së Policisë së Kosovës dhe drejtësisë/Ulja e sjelljeve korruptive dhe sjelljeve të këqija) janë realizuar disa aktivitete dhe punëtori.

Projekti ka ofruar trajnim për kapacitete analitike për IPK-në, bazuar në një pyetësorë mbi nevojat për raporte mbi trendin. Në kuadër të projektit është realizuar edhe një vizitë studimore në Hungari si pjesë e zbatimit të procedurave të Sistemit të Menaxhimit të Integritetit brenda Policisë së Kosovës dhe për të arritur synimet e komponentës 5.1.

Gjatë vizitës katër ditore pjesëmarrësve u janë prezantuar detyrat e Policisë Kombëtare të Hungarisë, dhe procedurat e njësisë së barabartë me Drejtorinë e Standardeve Profesionale.

Pjesa e lartpërmendur e vizitës studimore i përket komponentës 4.7 (këshillimi dhe mbështetja e nivelit menaxherial të PK-së, për të zbatuar masa gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit dhe keq sjelljes me sistemin e zyrtarit të integritetit) të projektit të binjakëzimit.

Vizita studimore gjithashtu arrin synimet e Komponentës 5 (fuqizimi i bashkëpunimit kombëtarë, rajonal dhe ndërkombëtarë në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe krimit financiar) duke vizituar agjencitë e zbatimit të ligjit të Hungarisë.

30. BASHKËPUNIMI I IPK-SË ME EULEX-IN

Misioni Evropian për Sundimin e Rendit dhe Ligjit – EULEX, ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në IPK. Bashkëpunimi ka qenë i një niveli të lartë, ku vlerësohet shumë kontributi i tyre këshillëdhënës si në fushën e hetimeve po ashtu edhe në atë të inspektimeve. Një falënderim i madh u shkon edhe Prokurorëve të EULEX-it të cilët kanë ndihmuar në disa raste të veprave penale, dhe pa asnjë hezitim kanë përkrahur IPK-në në çdo fazë të hetimeve.



Takimet e shumta që janë mbajtur edhe në mes të monitoruesve të këtij misioni dhe zyrtarëve të lartë të IPK-së, duke ofruar përvojat e tyre në çështjet me interes të dyanshëm, me qëllimin e vetëm për të arritur rezultate më të mira në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. IPK ka çmuar punën e këtij misioni në përmirësimin e rendit dhe ligjit në Kosovë.

Kontributi i këtij misioni ka qenë i theksuar përveç në ofrimin e këshillave dhe ekspertizës në çështje të ndryshme në zbatimin e funksioneve të IPK-së edhe në nxjerrjen dhe rishikimin e udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për IPK-në.

31. PËRKUFIZIMET

Shprehjet e përdorura në këtë raport kanë këtë kuptim:

HETUES – personeli i Inspektoratit Policor të Kosovës që zhvillon hetime penale ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës, përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv;

INSPEKTORËT – personeli i Inspektoratit Policor të Kosovës që zhvillon inspektime në Policinë e Kosovës;

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme;

MINISTRI – Ministri i Punëve të Brendshme;

IPK - Inspektorati Policor i Kosovës;

PUNONJËS I POLICISË SË KOSOVËS - tërë personeli i Policisë që përfshin zyrtarin policor dhe stafin civil të Policisë së Kosovës;

POLICIA - Policia e Kosovës;

INSTITUCIONET PËR ZBATIM TË LIGJIT - të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit që kanë autorizimet policore;

HETIMI I INTEGRITETIT - teknika apo metoda që shërben për verifikimin e etikës dhe integritetin e punonjësve të Policisë së Kosovës.

INSPEKTIM - vlerësimi i mënyrës së kryerjes së detyrave në Policinë e Kosovës, duke siguruar arritjen e qëllimeve, në përputhje me legjislacionin dhe standardet e kërkuara;

INCIDENT DISIPLINOR I PROFILIT TË LARTË - incidenti ose trendi i ngjarjeve që tërheqin vëmendje domethënëse të publikut duke përfshirë, por pa u kufizuar në supozimet si:

- konflikte apo incidente të drejtpërdrejta në mes policisë dhe komuniteteve që ndërlidhet me veprimet racore, etnike apo diskriminuese;
- një problem akut i konfliktit të drejtpërdrejtë në mes policisë dhe komuniteteve. Konflikti mund të jetë në formën e ngacmimit, brutalitetit apo përdorimit të forcës së tepruar nga ana e Policisë;
- të gjitha incidentet e përdorimit të forcës vdekjeprurëse;
- të gjitha vdekjet gjatë mbajtjes nën kontroll nga policia;
- aksidentet fatale të trafikut ku përfshihen punonjësit e policisë;

ANKESAT NDAJ SHËRBIMIT - ankesa e bërë lidhur me standardet policore, udhëzimet operative apo parimeve të shërbimit policor.

ANKESAT PËR SJELLJE KRIMINALE – ankesa për sjelljet kriminale të punonjësve policor të bërë me dije autoriteteve përkatëse.

32. SHKURTESAT

IPK	Inspektorati Policor i Kosovës;
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme;
PK	Policia e Kosovës;
ICITAP	International Criminal Investigative Training Assistance Program;
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë;
AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike;
KEEP	Kodi Evropiane i Etikës Policore;
UE	Unioni Evropian;
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë;
PSO	Procedura Standarde të Operimit;
NJTR	Njësia e Trafikut Rajonal;
NJHR	Njësia e Hetimeve Rajonale;
NJHDPK	Njësia e Hetimeve të Drejtorisë së Policisë Kufitare;
DRP	Drejtorja Rajonale e Policisë;
DPP	Drejtorja e Përgjithshme e Policisë;
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme;
TI	Teknologjia Informative;
DHS	Departamenti i Hetimeve Speciale;
DH	Departamenti i Hetimeve;



INSPEKTORATI POLICORË KOSOVËS
POLICINSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJEN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:

RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE



0800033333

Së bashku për një polici profesionale
Zajedno za profesionalnu policiju
Together for professional police